



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
MBI AUDITIMIN FINANCIAR
TË USHTRUAR NË
BASHKINË KAVAJË

Tiranë, tetor 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	3
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-9
a	Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Kavajë	4
b	Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij	4
c	Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave	4
d	Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave	4-5
e	Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve	5
f	Paraqitja e gjetjeve kryesore	5-6
g	Paraqitja e rekomandimeve kryesore	6-7
I.1	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	7-9
II	HYRJA	9-13
1	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	9
2	Identifikimi i çështjes	9-10
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10
4	Përgjegjësitë e audituesve	10
5	Kriteret e vlerësimit	10-11
6	Standardet e auditimit	11
7	Metoda e auditimit	12-13
8	Dokumentimi i auditimit	13
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13-93
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Kavajë	13-14
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	14-93
2.1	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm	14-25
2.2	Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore	25-54
2.3	Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	54-81
IV	REKOMANDIME	82-93

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit në Bashkinë Kavajë.

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 616/1 prot., datë 30.05.2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi **Bashkinë Kavajë**, për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024. Për vitin 2024 realizimi i shpenzimeve është në vlerën 2,240,806 mijë lekë ndërsa të ardhurat e veta janë në vlerën 1,036,818 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Kavajë për periudhën e aktivitetit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përparësitë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- ✓ *Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm;*
- ✓ *Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;*
- ✓ *Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare. Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 34,674 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik; Kontrolli me anë të pjesëve

justifikuese; Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese; Kontrolli i vlerësimit; Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi; Verifikimi i transaksioneve Intervistimi; Raporte dhe informacione; Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 20 gjetje dhe ka dhënë 23 rekomandime të cilat i përkasin kategorisë *Masa Organizative*.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

Nga auditimi i llogarive të Klasës 4, konkretisht llogarive të arkëtueshme konstatohet se:

- Gjendja e llogarisë 411 "*Klientë e llogari të ngjashme*" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,872,258 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 6,613,237 lekë me një rritje në vlerën 3,740,979 lekë. Në gjendjen e llogarisë 411 "*Klientë e llogari të ngjajshme*" janë përfshirë detyrimet që kanë Çerdhet dhe Kopshtet e qytetit ndaj institucionit në vlerën 2,872,258 lekë. Për diferencën në vlerën prej 3,740,979 lekë e pasqyruar në bilanc është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie. Llogaria 411 "*Klientë dhe llogari të ngjashme*" është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitore të llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*", në kredi të llogarisë 4341 "*Operacione me shtetin (detyrime)*" në pasiv të bilancit.

- Gjendja e llogarisë 423,429 "*Personeli, paradhënie, defiçite, gjoba*" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 91,540,628 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 91,540,628 lekë pra kjo llogari nuk ka shtesa apo pakësime. Llogaria 423,429 "*Personeli, paradhënie, defiçite, gjoba (debitor)*", e pasqyruar në bilanc për vlerën 91,540,628 lekë është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie.

- Gjendja e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 747,814,846 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 879,878,586 lekë, të cilat konsiderohen detyrime të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Kavajë, me një rritje në vlerën 132,063,740 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" nuk janë të përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Me shkresën nr. 1214 prot., datë 17.03.2025, Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit mbi borxhin tatimor progresiv më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 879,878,586 lekë pa përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 "*Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë*" me kundërparti llogarinë 468 "*Kreditorë të ndryshëm*", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.

- Llogaria 202 "*Studime dhe kërkime*" më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 125,701,505 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 7,555,680 lekë, pakësime në vlerën 14,185,880 lekë amortizim të akumuluar në vlerën 18,855,226 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 100,216,079 lekë. Vlera e mbetur në fund të vitit 2024 prej 122,396,352 lekë (*që i përket kostos historike*) e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 "*Studime dhe Kërkime*", për projekt-studime të pa analizuara për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik. Për këto vlera duhet të detajohen sipas investimeve dhe të

kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

- Nga auditimi i llogarive të Klasës 20, konkretisht aktiveve afatgjata materiale u konstatua se:

a. Llogaria 210 *“Toka, troje, terrene”* e pasqyruar në bilanc për vlerën 35,121,363 lekë dhe llogaria 211 *“Pyje, kullota, plantacione”* në vlerën 10,971,000 lekë, janë të pa analizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari.

b. Në gjendjen e llogarisë 212 *“Ndërtesa e konstruksione”* në vlerën 1,312,690,760 lekë kosto historike është përfshirë vlera 263,494,134 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Pjesë e analizës së kësaj llogarie janë kontabilizuar 5 aktive jo me vlerë plotë.

c. Në gjendjen e llogarisë 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* në vlerën 3,437,945,420 lekë kosto historike është përfshirë vlera 569,988,759 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

d. Në gjendjen e llogarisë 215 *“Mjete transporti”* në vlerën 154,454,921 lekë kosto historike është përfshirë vlera 29,552,098 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

- Gjendja e llogarisë 231 *“Për aktivet afatgjata materiale”* më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,842,855,911 lekë. Për këtë llogari nuk disponohet informacion mbi shtesat dhe pakësimet e kësaj llogarie, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,597,687,327 lekë. Nga auditimi u konstatua se, nuk dokumentohet pakësimi i 77 objekteve në gjendjen e llogarisë 231 *“Për aktive afatgjata materiale”* në vlerën 1,287,219,125 lekë pra shpërndarja e tyre në aktiv. Ndërkohë që shtesa për vitin 2024 në gjendjen e llogarisë 212 *“Ndërtesa e konstruksione”* është 68,181,062 lekë dhe 213 *“Rrugë rrjete vepra ujore”* është 3,198,000 lekë. Për më tepër nuk disponohet analiza për vlerën 1,555,636,786 lekë të mbetur të çeljes së datës 01.01.2024.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 *“Investime për aktive afatgjata jo materiale”* paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 *“Investime për aktive afatgjata materiale”* në vlerën 2,597,687,327 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 2,597,687,327 lekë. Ky total nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 *“Nga fondet e veta të investimeve”* e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 *“Teprica e grandeve kapitale të brendshme”* në vlerën 0 lekë.

- Çelja e llogarisë 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”* më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 8,049,666,667 lekë. Llogaria 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”* kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”* në vlerën 135,180,102 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 14,637,945 lekë sipas llogarisë 63 *“Ndryshimi i gjendjes së inventarit”*. Llogaria 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”* debitohet për pakësimet e vitit në vlerën 31,183,231 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 254,399,416 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”*. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”* është nënvlerësuar në vlerën 494,125,791 lekë.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për analizimin, detajimin e dokumentacionit ligjor për diferencën në vlerën 3,740,979 lekë që i përket çeljes së llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjajshme” me qëllim saktësimin e vlerave në pasqyrat financiare.
- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë detajimin e dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogarinë 423 dhe 429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)” të kontabilizuara në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.
- Drejtoria e Burimeve Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave, të Ardhurave dhe Borxhit të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”.
- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke riklasifikuar në llogaritë e investimeve përkatëse sipas llojit në vlerën 122,396,352 lekë për një paraqitje të plotë e të saktë të aktiveve afatgjata materiale, si dhe aplikimin e normës së amortizimit.
- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë analizë të detajuar të dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogaritë e aktiveve afatgjata të Klasës 20, (210, 212, 213 dhe 215) për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.
- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë zërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor të llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” për nxjerrjen e të dhënave për vlerën 1,555,636,786 lekë që i përket investimeve të kryer ndër vite dhe të diferencës ndërmjet çeljes dhe shtesave, pakësime në vlerën 1,287,219,125 lekë, për të verifikuar saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare.
- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të evidentojë pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.
- Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Kavajë, Grupi i Auditimit të KLSH-së ka dhënë “Opinioni i modifikuar/kualifikuar me rezervë” për pasqyrat financiare. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2024:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Kavajë për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i

parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Kavajë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të “modifikuar, me rezervë”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Bazat për opinionin e modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej **34,674 mijë** lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Në gjendjen e llogarive 411 “Klientë e llogari të ngjashme” në vlerën 6,613,237 lekë është përfshirë vlera 3,740,979 lekë e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të kësaj llogarie.

- Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 91,540,628 lekë është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie.

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 879,878,586 lekë, në të cilën nuk janë të përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.

- Në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

- Vlera e mbetur në fund të vitit 2023 prej 122,396,352 lekë (*kosto historike*) e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, për projekt-studime të pa analizuar për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.

- Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” e pasqyruar në bilanc për vlerën 35,121,363 lekë dhe llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” në vlerën 10,971,000 lekë, janë të pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari.

- Në gjendjen e llogarive 212 “Ndërtesa e konstruksione” është përfshirë vlera 263,494,134 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është përfshirë vlera 569,988,759 lekë dhe 215 “Mjete transporti” është përfshirë vlera 29,552,098 lekë të pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Këto vlera janë trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë të paanalizuara dhe ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, që rezultojnë të pa inventarizuara dhe të llogaritjes së amortizimit.

- Nuk dokumentohet pakësimi i 77 objekteve në gjendjen e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” në vlerën 1,287,219,125 lekë, pra shpërndarja e tyre në aktiv. Ndërkohë që shtesa

për vitin 2024 në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” është 68,181,062 lekë dhe 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është 3,198,000 lekë. Për më tepër nuk disponohet analiza për vlerën 1,555,636,786 lekë të mbetur të çeljes së datës 01.01.2024.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 2,597,687,327 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

- Në gjendjen e llogarive 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është përfshirë vlera 53,386,933 lekë e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare.

- Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 494,125,791 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 616/1 prot., datë 30.05.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 05.06.2025, deri më 07.07.2025, në institucionin Bashkia Kavajë u krye auditimi “Mbi auditimin financiar” për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024. Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M. H. (Përgjegjës grupi)
2. H. I., anëtar
3. E. S., anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIME DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

2. Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bzaë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kavajë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të

grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Kavajë.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Titullari i institucionit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për gatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”* i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”* i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tjera.

4. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Kavajë në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullësia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Kavajë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 *“Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”*, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit: Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.14, *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrisë së Çështjeve Vendore dhe Ministrisë së Financave nr. 3237, datë 16.07.2015, “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 26, datë 27.09.2019, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”;

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave lokale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare” i ndryshuar;
- VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë” i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”;
- INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.;
- Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metoda e auditimit: Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin¹:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve);

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj.,. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt;

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre;

5. Konfirmim nga të tretët:

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (*Rakorduar*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër;

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.,.

- Verifikimi i transaksioneve është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- Intervistimi është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

¹ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- Raporte dhe informacione janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

8. Dokumentimi i auditimit: Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimin e mbajtur, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Kavajë”:

Bashkia e Kavajës kufizohet në veri nga Bashkia Durrës, në lindje nga Bashkia Tiranë, në jug nga Bashkia Rrogozhinë dhe në perëndim nga deti Adriatik. Qendra e kësaj Bashkie është qyteti i Kavajës. Bashkia e Kavajës është pjesë e Qarkut Tiranë dhe përbëhet nga 5 njësi administrative të cilat janë: (Kavaja, Synej, Luz i Vogël, Golem dhe Helmas). Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej një qytet dhe 32 fshatra.

Qendra e Bashkisë	NJA	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Kavajë	Kavajë	Qyteti Kavajë
	Synej	Synej, Butaq, Rrikaj, Hajdaraj, Peqinaj, Rrakull, Bago
	Luz i Vogël	Luz i Vogël, Vorrozen, Beden, Blerimaj
	Golem	Golem, Kryemëdhënj, Tilaj, Seferaj, Golemas, Qerret, Karpen, Zik-Xhafaj, Kanaparaj, Agonas, Karpen i Ri
	Helmas	Helmas, Zikular, Lis-Patros, Shtodhër, Cetë, Momël, Habilaj, Collakaj, Kryezi, Cikallesh

Organizimi i Bashkisë Kavajë:

- Bashkia Kavajë ka nën varësi njësitë shpenzuese;
- Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve;
(Sektori i Çerdhes së Qytetit në Drejtorinë e Shërbimit Social)
- Drejtoria Ekonomike e Arsimit;
(Agjencia e Arsimit Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Para Universitar dhe Qendrat Kulturore)
- Drejtoria Ekonomike e Kulturës;
(Drejtoria e Kulturës)
- Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;
Sektori M.Z.SH (Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi)
- Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore;
(Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike)
- Sport Klub B.
(Sektori i Shumë Sporteve)

Funksionet kryesore të Bashkisë Kavajë kryhen në fushën e:

- Infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
- Shërbimeve sociale;
- Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;

- Mbrojtjes së mjedisit;
- Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike;
- Zhvillimit ekonomik vendor;
- Sigurisë publike.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.

1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK:

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një koncept i rëndësishëm, i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- *Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;*
- *Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;*
- *Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.*

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga stafi i Bashkisë Kavajë, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi nr. 1. “Njësia publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike”:

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Kavajë në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

- Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se bashkia vepron mbi bazën e Rregullores së Brendshme miratuar me Vendimin nr. 3223 prot., datë 02.12.2016, “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Kavajë”. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për strukturat e institucionit. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezultoi se në rregulloren e brendshme përfshihen vetëm **46** pozicione pune të strukturës aktuale përkatësisht:

- **5** pozicione pune me statusin funksionar politik;
- **1** pozicion pune me statusin i zgjedhur;
- **25** pozicione pune me status të nëpunësit civil;
- **15** pozicione pune me kontratë;

Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Kavajë nuk ka rishikuar rregulloren e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore.

- Bashkia Kavajë ka hartuar urdhrin për Kodin e Etikës me nr. 168, datë 15.04.2024. Për zbatimin

e tij bashkia mbështetet në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”; Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik.

- Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka asnjë procedurë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj. Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.

- Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Kavajë në përputhje me Ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit” e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 87 prot., datë 08.01.2025.

- Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Kavajë e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 87 prot., datë 08.01.2025.

Gjatë vitit 2024 nuk janë marrë masa disiplinore:

- Për rastet e raportimit lidhur me ankesat për korrupsion, funksionon Sektori i Çështjeve të Antikorrupsionit, ngritur pranë bashkisë, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2025, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

- Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore nuk bashkëpunon me zyrtarët raportues dhe zyrtarin autorizues në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.

Parimi nr. 2. “Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”:

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

- Për vitin 2024, situata paraqitet **jo efektive**, vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga drejtoritë e bashkisë, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion.

- Titullari i bashkisë nuk mbikëqyr projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

- Nuk rezulton të ketë urdhër për miratimin e planit të veprimit për kontrollin e brendshëm dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij plani.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e AB nëpërmjet veprimtarisë audituese.

- Titullari i bashkisë nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë.

Parimi nr. 3. “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”:

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (*organigramën*), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit/Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

- Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritetet në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

- Me Vendimin nr. 1, datë 04.01.2024, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kavajë” për vitin 2024, titullari ka miratuar strukturën e përbërë nga **681** punonjës, pozicione pune që përfshijnë edhe funksionet e deleguara e të transferuara si dhe **29** vende pune të përkohshme

për pozicionet “Mjeshtër Uji” dhe “Polic Bashkiak Sezonal Bregdeti” për periudhën 14 maj-14 shtator 2024. Kjo strukturë ka ndryshuar me Vendimin nr. 1/7, datë 04.11.2024, e përbërë nga **706** punonjës. Përgjatë vitit 2024 janë rekrutuar **120** punonjës dhe janë larguar **34** punonjës.

Struktura e Bashkisë Kavajë për vitin 2024

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	706	Nëpunës Civilë	124
		Nëpunës me kontratë	555
		Të zgjedhur	2
		Funksionar Politik	25

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Nga auditimi konstatohet se nuk është rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë nuk ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mirë përcaktuara.

- Rezulton se delegohen përgjegjësitë brenda bashkisë nga ana e menaxherëve nëpërmjet urdhrave të delegimit por nuk analizohen risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara.

- Evidenca të analizës së riskut ka vetëm nga Njësia e Auditit të Brendshëm.

Parimi nr. 4. “Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave”:

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

- Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

Përshkrimet e punës nuk janë rishikuar periodikisht edhe pse bashkia ka ndryshuar strukturën e saj.

- Nuk janë kryer vlerësimet periodike të punonjësve nga menaxherët në lidhje me arritjen e objektivave dhe respektimin e Kodit të Etikës.

- Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore mbi rekrutimet dhe largimet, rezultoi se përgjatë vitit 2024 janë rekrutuar 120 punonjës dhe janë larguar 34 punonjës.

- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. **Për vitin 2024** janë kryer **3** trajnime për nëpunës të institucionit dhe kanë marrë pjesë **3** nëpunës.

- Bashkia Kavajë nuk disponon një regjistër të detajuar për regjistrimin e trajnimeve të kryera nga nëpunësit e institucionit si dhe nuk parashikohen fonde në buxhet për trajnime në fusha të ndryshme.

- Institucioni ka miratuar Vendimin nr. 79, datë 19.13.2023, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetin e Bashkisë Kavajë për vitin 2024”.

- Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13, të Ligjit 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe VKM nr. 160, datë 02.03.2016, “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit”.

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka verifikuar respektimin e kuadrit ligjor nga ana e bashkisë për rekrutimin (*punësimin*) e punonjësve gjatë kësaj periudhe kohore, konkretisht:

1. Për punësimin e z. H. K., i punësuar me aktin nr. 31, datë 23.01.2024, “Urdhër për punësim” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Inspektor” në sektorin e Verifikimit në Terren në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit transferohet me detyrën “Specialist” Tatim Takasa Njësia Administrative Helems në Sektorin e të Ardhurave dhe Tarifave Vendore me aktin nr. 88, datë 01.02.2024, deri kur ky pozicion të plotësohet sipas dispozitave të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nga verifikimi i dosjes së personelit rezultoi se nga ana e Bashkisë Kavajë nuk rezultoi, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

2. Për punësimin e z. G. Gj., i punësuar përkohesisht me aktin nr. 342, datë 02.09.2024, “Urdhër për punësim” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Drejtor” në Drejtorinë e Shërbimeve Publike deri kur ky pozicion të plotësohet sipas dispozitave të Ligjit nr. 152/2013, “Për nënpunësin civil”, nga verifikimi rezulton se nga ana e Bashkisë Kavajë nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

3. Për punësimin e z. E. C., i punësuar me aktin nr. 125, datë 04.03.2024, “Urdhër për punësim” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Drejtor” në Agjencinë e Arsimit Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Para Universitar dhe Qendrat Kulturore nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se nga ana e Bashkisë Kavajë nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

4. Për punësimin e z. I. K., i punësuar me aktin nr. 26, datë 23.01.2024, “Urdhër për punësim” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Specialist Jurist” në Policinë Bashkiake, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se nga ana e Bashkisë Kavajë nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

5. Për punësimin e z. E. G., i punësuar me aktin nr. 265, datë 24.06.2024, “Urdhër për punësim” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Inspektor” në Sektorin e Verifikimit në Terren në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxh, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se nga ana e Bashkisë Kavajë nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

- Në lidhje me vlerësimin periodik të performancës së punonjësve.

Në lidhje me mënyrën e vlerësimit periodik të performancës së punonjësve, Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” i ndryshuar, ndër të tjera, në Kreun II, parashikon sistemin e vlerësimit të rezultateve në punë, si procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo i dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, **që realizohet çdo 6 muaj të vitit kalendarik**. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese kryhet bashkërisht nga zyrtari raportues, zyrtari kundër firmues dhe zyrtari autorizues.

Së pari, nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, për nëpunësit civil, konstatohet se vlerësimet e performancës, nuk janë pjesë e tyre. Këto të fundit nuk administrohen në dosje në mospërputhje me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, pika II/1 sipas të cilës: “Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit të përgjithshëm, profesional, akademik, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe të dhëna të tjera...”.

Së dyti, nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjeve të personelit, për punonjësit me kontratë pune, konstatohet se nuk ka vlerësime të performancës, në kundërshtim me VKM nr. 109, datë 26.02.2014, Kreu II, “Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë, si procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo i dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj të vitit kalendarik ...”;

Si konkluzion: Mungesa e formularëve të vlerësimit të performancës si dhe mungesa e njoftimit të tyre, ndikon negativisht në menaxhimin e marrëdhënies së punës midis palëve si dhe përbën një risk eventual të shtuar për institucionin e Bashkisë Kavajë.

Për sa më sipër, Bashkia Kavajë ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Titullari i institucionit.

- Punësimi pranë Bashkisë Kavajë i nëpunësve për të cilët nuk është zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi e hapur, përveçse bie ndesh me interesin publik, parimin e konkurrencës së lirë dhe barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar duke ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e punës në Bashkinë Kavajë.

Për sa më sipër, Bashkia Kavajë ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën e R. Sh., Ligji nr.

152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nenet 5, 20, 22, 23, 24, 25, 26 , VKM nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar, VKM nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Titullari i institucionit.

Parimi 5. “Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”:

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësiave dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm. - Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, rezulton se bashkia nuk i ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale për hartimin dhe monitorimin e objektivave strategjike në dokumentin e rregullores së brendshme. Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në GMS, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Për vitin 2024, është ngritur Urdhri nr. 875, datë 23.10.2023, për ngritjen e GMS për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026. GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. Bashkia Kavajë nuk zhvillon takimet e GMS, të dokumentuara me procesverbale. Për vitin 2024, nuk është përcjellë në MFE “*Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Kavajë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm*”.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”:

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi nr. 6. “Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva”:

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët/NA/Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

- Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 është miratuar me VKB nr. 6, datë 28.02.2023.

- Dokumenti përfundimtar i PBA 2024-2026 është miratuar me VKB nr. 79, datë 19.12.2023.

- Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 është dërguar në MFE me nr. 166, datë 07.07.2023.

Është e rëndësishme që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, bashkia nuk ka plan veprime vjetore operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve dhe politikave afatmesme dhe objektivave vjetore që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

Parimi nr. 7. “*Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave*”:

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e këtij parimi konstatohet se, bashkia nuk ka përcaktuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.

- Nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Kavajë si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimit efektiv të tyre.

- Titullari i bashkisë nuk ka ngritur urdhër për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet e për rrjedhojë nuk ka as raportime tek menaxherët e risqeve. Konstatohet se, nuk ka plan-veprime për menaxhimit e riskut.

Parimi nr. 8. “*Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve*”:

Mashtrimi ekziston (*ose mund të ndodhë*) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

- Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, Bashkia Kavajë nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi nr. 9. “*Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme*”:

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

- Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, rezulton se, efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel të ulët. Konstatohet se, Bashkia Kavajë nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale nuk janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualët e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”:

Veprimtaritë e kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi nr. 10. “*Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit*”:

Nuk ka “zgjedhje ideale” në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (*politikat, procedurat dhe përgjegjësitë*) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

- Në vijim të auditimit të kryer, mund të themi se ka problematika për t’u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e hartave apo manualeve të proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësi.

Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda

të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij. *Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezultojnë se asnjë prej drejtorive nuk ka hartë dhe manual të proceseve të punës.*

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Nga komunikimi me punonjësit e Drejtorisë së Burimeve rezultojnë se, ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person. Detyrat janë të ndara. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga nëpunësi zbatues, regjistrohet nga specialisti i buxhetit dhe miratohet nga nëpunësi zbatues. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga specialisti për kontabilitetin dhe autorizimi i pagesës kryhet nga nëpunësi autorizues.

Në zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, bashkia ndjek procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, KVO, komisionin për pranimin e mallit etj.,.

- Në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018, “Për hartimin e regjistrimit të parashikimeve të procedurave të PP dhe krijimi i tyre në sistemin e PP” është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve.

- Bashkia Kavajë ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.

- Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike” i ndryshuar.

Gjurma e auditimit:

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë.

Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë.

- Nga auditimi i kryer, konstatohet se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.

Gjurma e auditimit duhet të ndërtohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Parimi nr. 11. “Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë”:

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

- Bashkia Kavajë nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS).

- Nga auditimi rezultojnë se bashkia nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it.

Bashkia nuk ka vendosur procedura për të siguruar vazhdimësinë e veprimeve kundrejt risqeve kryesore që mund të pengojnë këtë veprimtari. Pra, nuk ka plane të riskut për sigurinë e aktiveve nga zjarri/përmytjet dhe rimëkëmbjet nga fatkeqësitë.

Parimi nr. 12. *“Njësia Publike vendos aktivitetet kontrollit përmes politikave dhe procedurave”:*

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

Nga auditimi i kryer konstatohet se, bashkia nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj dhe nuk ka procedura të shkruara operative për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

IV. Komponenti “Informimi dhe komunikimi”:

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi nr. 13. *“Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor”:*

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

- Në vijim të auditimit rezultoi se, bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit. bashkia ka një sistem komunikimi si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

- Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Parimi nr. 14. *“Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm”:*

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

- Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, proces verbalët e mbledhjeve komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare. Faqja zyrtare e institucionit nuk përditësohet rregullisht dhe punonjësit nuk kanë e-mail zyrtar. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi nr. 15. *“Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm”:*

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia nuk siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.

- Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Për vitin 2024 janë zhvilluar 5 dëgjesa publike në Bashkinë Kavajë. Dëgjesat Publike janë zhvilluar në lidhje me Paketën Fiskale dhe Projekt Buxhetin për vitin 2025 sipas kalendarit të mëposhtëm:

- Njësia Administrative Helmas, më datë 05.11.2024, ora 11:00;
- Njësia Administrative Golem, më datë 07.11.2024, ora 11:00;

- Njësia Administrative Luz i Vogël, më datë 05.11.2024, ora 11:00;
- Njësia Administrative Synej, më datë 06.11.2024, ora 11:00;
- Njësia Administrative Kavajë, më datë 11.11.2024, ora 11:00;

V. Komponenti “Monitorimi”:

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi nr. 16. *“Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm”:*

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

- Nga auditimi i kryer, konstatohet se, institucion nuk ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ende nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Bashkia Kavajë monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili nuk është dërguar në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga NjAB. NjAB ka kryer auditim mbi MFK i cili është formal dhe pa u thelluar analitikisht për çdo subjekt të audituar. Bashkia nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

NjAB ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2024.

Parimi nr. 17 *“Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”:*

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndër marrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi. *Në bazë të auditimit të kryer, konstatohet se, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH nuk ka ndër marrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe nuk ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.*

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për MFK e brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga rezultatet e testeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Funksionimi i sistemit të MFK ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar. Bashkia nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave elektronike (*sistem rezervë back-up*), si dhe ruajtjen e aktiveve. Nuk është hartuar një regjistër i risku, dokumenti i listës (*hartës*) së proceseve të punës, dhe dokumenti i gjurmës së auditimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, Kreu II, neni 8, neni 16, pika 2, nent 20-24, VKM nr. 833, datë 28.10.2020, *“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve*

të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Kreu II “Dosja e Personelit”, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3, pika 3.2.1, pika 4, pika 5.2.7, Manualin për MFK-në i miratuar me Urdhrin nr. 108/2016, Kapitulli III, pika 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.5.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. F. Q. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë, **z. A. C.** në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Ekonomike, **znj. F. Gj.** në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe **znj. Z. Sh.** në cilësinë e Përgjegjëses së NjAB.

Mbi vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm:

NjAB përgjatë periudhës objekt auditimi, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit nr. 1, datë 03.01.2024, duke pasur në strukturën e saj 1 Përgjegjës i Auditit të Brendshëm znj. Z. Sh. dhe 2 Specialiste Auditit, znj. B. L. e pa certifikuar dhe znj. E. T. e certifikuar si audituese e brendshme. Znj. F. T. me detyrë specialiste në NjAB është liruar nga detyra pas mbushjes së moshës së pensionit me Urdhër Lirimi nr. 248, datë 12.06.2024, dhe nr. 3244 prot., datë 12.06.2024. NjAB në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së saj, ka miratuar rregulloren e brendshme me nr. 3725 prot., datë 02.12.2021, e cila përcakton mënyrën e organizimit, kuadrin ligjor, detyrat e përgjegjësit të NjAB dhe audituesve të brendshëm etj.,.

Struktura e njësisë AB për vitin 2024

Nr.	Periudha	Funksioni	Arsimi bazë	Niveli i diplomës	Vjetërsi pune	Vjetërsi në auditim/vit	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
1	Z. Sh.	Përgjegjës e NjAB	Ekonomiste	Master Shkencor	35	31	2010	Po
2	B. L.	Audituese	Ekonomiste	Master Shkencor	3		-	Po
3	E. T.	Audituese	Inxhinieri	Master Profesional	8	5	2021	Po
4	F. T.	Audituese	Ekonomiste	Master Shkencor	39	19	2010	Larguar Qershor 2024

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Trajnimet e NjAB dhe certifikimet:

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve të NjAB sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Për vitin 2024 trajnimet e audituesve të NjAB për Bashkinë Kavajë pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Trajnimet e NjAB për vitin 2024

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i Punës /Drejtoria	Tema e trajnimit te ndjekur	Institucioni Trajnues	Data e trajnimit dhe mënyra e ndjekjes së trajnimit (online/Fizik)
1	Z. Sh.	Përgjegjëse	1.Analiza Financiare, Auditimi i Pasqyrave Financiare 2. Roli i NjAB në përputhje me standartet Ndërkombëtare të AB	Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm	9-13 Tetor (40 orë) Trajnim Fizik
2	B. L.	Audituese	1.Analiza Financiare, Auditimi i Pasqyrave Financiare 2. Roli i NjAB në përputhje me standartet Ndërkombëtare të AB	Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm	21 Tetor (8 orë) - online 23-24 Tetor (16 orë) - fizik. 11-15 Nëntor (40 orë) - fizik
3	E. T.	Audituese	1.Analiza Financiare, Auditimi i Pasqyrave Financiare 2. Roli i NjAB në përputhje me standartet Ndërkombëtare të AB	Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm	21 Tetor (8 orë) - online 23-24 Tetor (16 orë) - fizik. 11-15 Nëntor (40 orë) - fizik

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Komiteti i Auditit të Brendshëm:

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12, pika b.

Karta e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik:

NjAB në mbështetje të UMF nr. 100, datë 25.10.2016, “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e auditimit të brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Kavajë e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr. 796/1. prot., datë 07.02.2024, dhe rezulton se është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm,

miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016”.

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve:

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar Plani Strategjik 2024-2026 i cili është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 4907/3 prot., datë 15.10.2024. Plani vjetor i auditimeve për vitin 2024 është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 4907/2 prot., datë 1.10.2024. Plani Strategjik dhe Plani Vjetor janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë MFE, me shkresën nr. 817/1 prot., datë 17.02.2025, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe UMF nr. 100, datë 25.10.2016, “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NjAB për vitin 2024:

Në planin vjetor të auditimit për vitin 2024, miratuar me nr. 4907/2 prot., datë 1.10.2024, janë programuar për auditim drejtori brenda strukturës së bashkisë dhe institucione në varësi të saj. **Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024**, nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë planifikuar për t’u kryer **8** auditime kundrejt **8** auditimeve të programuara, pra plani vjetor është realizuar 100%, nga të cilat **8** auditimet të programuara, pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Planifikuar	Nr.	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduara	Në proces
					Përp..	Perf..	Finan..	IT	Kombinuara		
1	Drejtoria e Burimeve Ekonomike	1	DBE	1	0	0	0	0	1	1	0
2	Spektori i Policisë Bashikake	1	SPB	1	1	0	0	0	0	1	0
3	Drejtoria e Shërbimit Social	1	DShS	1	1	0	0	0	0	1	0
4	Drejtoria e Shërbimeve Publike (Spektori i Varrezave)	1	IMTV	1	1	0	0	0	0	1	0
5	Drejtoria e Shërbimeve Publike (Spektori i Gjëlberimit)	1	DSHP (Spektori i Gjëlberimit)	1	1	0	0	0	0	1	0
6	NjA Luz i Vogël	1	NjA Luz i Vogël	1	0	0	0	0	1	1	0
7	NjA Golem	1	NjA Golem	1	0	0	0	0	1	1	0
8	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	1	DTTV	1	1	0	0	0	0	1	0
Totali		8	Totali	8	5	0	0	0	3	8	0

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, për aktivitetin e vitit 2024 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 817 prot., datë 17.02.2025. Nga auditimi i raportimit për vitin 2024, u konstatua se janë dhënë 35 rekomandime gjithsej, të cilat janë të karakterit organizativ dhe janë pranuar nga subjektet objekt auditimi.

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar	Në proces	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	2024	35	35	0	0	0	0	0	
Totali		35	35	0	35	0	0	0	

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën 01.01.2024, deri më 31.12.2024, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Kavajë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Burimeve Ekonomike (sistemi i prokurimeve), në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit pika 3.1.3.

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB:

Grupi auditimit duke patur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2024, zgjodhi të auditojë dosjet të cilat janë vlerësuar nga DAB me nivel të mesëm dhe të lartë risku siç janë:

- Dosja e auditimit të kryer në Njësinë Administrative Golem;
- Dosja e auditimit të kryer në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore” (Spektori i Menaxhimit të Borxhit);
- Dosja e auditimit të kryer në Njësinë Administrative Luz i Vogël;
- Dosja e auditimit të kryer në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike (Spektori i Buxhetit dhe Kontabilitetit Financiar);

Për sa trajtuar më sipër, në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (*e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara*) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar; NjAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara.

Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm:

NjAB në Bashkinë Kavajë ka hartuar “*Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm*” i cili rezulton të jetë i miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 104/1 prot., datë 27.01.2025. Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Kavajë në përputhje me Ligjin nr. 60/2016, “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit*” e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 87 prot., datë 08.01.2025. Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Kavajë e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 87 prot., datë 08.01.2025.

Dosja e përhershme:

Nga kontrolli i dokumentacionit u konstatua se, audituesit e brendshëm nuk kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit në mos përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm ku përcaktohet se: “*NjAB mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet*”. Dosja e përhershme duhet të përditësohet pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e saj. Dosja e përhershme mbahet në format elektronik ose të printuar, kjo në funksion të mundësive të NjAB.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, NjAB në Bashkinë Kavajë nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 “*Dosja e Përhershme*”.

- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenet 12, 13, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar;
- Për periudhën 01.01.2024, deri më 31.12.2024, nuk janë audituar aktivitetet që kryen Bashkia Kavajë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Ligjore, Drejtoria e Burimeve Ekonomike (*sistemi i prokurimeve*), në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit;
- NjAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;
- NjAB nuk ka kryer auditim tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH;

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. F. Q. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kavajë dhe **znj. Z. Sh.** në cilësinë e Përgjegjëses të NjAB.

2.2. Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

2.2.1. Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiare:

- Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre;
- Inventarizimi periodik;

2.2.2. Auditim i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të:

- Llogarive të arkëtueshme;
 - Llogarive të pagueshme;
- 2.2.3. Auditim i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare:**
- Mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat;
 - Mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Kavajë për vitin ushtrimor 2024 janë të nënshkuara nga z. F. Q. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. A. C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në cilësinë e Nëpunësit Zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Kavajë me shkresën nr. 1507 prot., datë 05.06.2025, dhe konfirmuar nga DTH Kavajë me shkresën nr. 122 prot., datë 05.06.2025, jashtë afatit ligjor (66 ditë me vonesë). Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli V, “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore”, pika 118.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (*vlerësimi kontabël*);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (*barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive*) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në E. dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj..
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (*ose në bazë të të drejtave të konstatuara*), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Programimi i PBA-së 2024-2026 dhe programimi i buxhetit vjetor 2024:

Me Urdhrin nr. 875, datë 23.10.2023, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (*GMS*) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2024-2026. Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 është miratuar me VKB-në nr. 6, datë 28.02.2023. Dokumenti përfundimtar i PBA-së 2024-2026 është miratuar me VKB-në 79, datë 19.12.2023. PBA-ja për

vitet 2024-2026 është dërguar pranë MFE-së me shkresën nr. 166 prot., datë 07.07.2023. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	Buxheti Faktik 2023	Faza e I PBA 2024	Faza e II PBA 2024	Projekt Buxhet 2024
600	Paga	417,434,431	510,561,671	510,561,671	510,561,671
601	Sigurime Shoqërore	69,874,037	80,344,312	80,344,312	80,344,312
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	476,070,188	600,523,910	600,523,910	600,523,910
604.603	Mallra dhe Shërbime të Tjera	907,500	19,657,606	19,657,606	19,657,606
606	Trans për Buxhete Familjare & Infdividë	37,017,645	12,798,616	12,798,616	12,798,616
I	Shpenzime Korrente	1,001,303,801	1,223,886,115	1,223,886,115	1,223,886,115
230	Kapitale të Patrupëzuara	1,775,081	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	1,052,832,587	166,619,885	166,619,885	166,619,885
Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		1,054,607,668	166,619,885	166,619,885	166,619,885
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
Shpenzime Kapitale me financim të huaj		0	0	0	0
II	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0
III	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limiti	0	0	0	0
I + II + III Totali i Shpenzimeve		2,055,911,469	1,390,506,000	1,390,506,000	1,390,506,000

Gjatë vitit 2024, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2023). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

Lekë

Periodha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/datë	Vlera	Nr/datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull			
					Shtesa	Vlera	Pakësime	Vlera
Viti 2024	Nr. 79, datë 19.12.2023	1,390,506	VKB nr. 5, datë 27.02.2025	772,025	600 + 601	23,411	600 + 601	0
					602 - 609	410,383	602	
					230 + 231	338,230	230 + 231	0
			VKM nr. 503, datë 01.08.2024	15,250	600 + 601	15,250	600 + 601	0
					602- 609		602	
					230 + 231		230 + 231	
			VKM nr. 419, datë 26.06.2024	1,712	600 + 601	1,712	600 + 601	0
					602		602	
					230 + 231		230 + 231	
			VKM nr. 425, datë 26.06.2024	9,651	600 + 601	9,651	600 + 601	0
					602		602	
					230 + 231		230 + 231	
VKB nr. 53, datë 30.09.2024	19,750	600 + 601	19,750	600 + 601	0			
		602		602	0			
		606		606	0			
Shkresa nr. 5449 prot., datë 24.10.2024	18,000	600 + 601		600 + 601	0			
		602	18,000	602	0			
		231		231	180,000			
Shkresa nr. 4018 prot., datë 01.08.2024	520,688	231	520,688					
VKM nr. 828, datë 26.12.2024	98,003	231	98,003					

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Kavajë për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024**. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuandrojnë me ato analitike.

Llogaritja e nivelit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024:

000/Lekë

Bashkia Kavajë 2024, Materialiteti për shpenzimet			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për t'u shqyrtuar
Paga (600)	499,354	0.70	12
Sigurime Shoqërore (601)	83,267	0.70	2
Mallra e Shërbime (602)	705,973	0.70	18
Investime të brendshme (230-231)	427,426	2.00	30
Të tjera transferime korrente (606)	17,712	0.70	0

Total	1,733,734		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	34,674		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	34,674		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	3,467		
Nëntotali	31,207		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	28,086		
Bashkia Kavajë 2024, Materialiteti për të ardhurat			
Emërtimi i të ardhurave	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Cështje për t'u shqyrtuar
Të ardhurat nga buxheti	0	0.70	24
Të ardhurat e veta	1,036,818	0.70	4
Total	1,036,818	0.70	8
Materialiteti në %	2%	0.70	8
Materialiteti	20,736		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	20,736		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	2,073		
Nëntotali	18,662		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
Vlera e precizionit	16,796		

Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Me Urdhrin nr. 355, datë 12.09.2024, të z. F. Q. Kryetar i Bashkisë është ngritur komisioni për inventarin fizik të aktiveve të Bashkisë Kavajë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2024, i përbërë nga znj. B. A. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. S. B., znj. B. H.

Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i sipërpërmendur është hartuar me shkresën nr. 4568 prot., datë 31.12.2024, raporti për inventarin fizik drejtuar Kryetarit të Bashkisë. Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.,.

Për vitin 2024 në gjendjen e Pasqyrës nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, është kryer pakësim për llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 16,997,351 lekë e cila i përket tre objekteve: “Kopshti Fiqiri Kurti” në vlerën 7,378,005 lekë; “Ndërtesa e stadiumit & muri rrethues” në vlerën 9,148,646 lekë dhe “Ndërtim muri rrethues fusha e vjetër” në vlerën 470,700 lekë.

Pakësimi nga kontabiliteti i këtyre objekteve është kryer në zbatimin të VKB-së nr. 62, datë 29.09.2023, “Për shembjen e detyruar të ndërtesës së kopshtit “Fiqiri Kurti” si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019” dhe VKB-në nr. 49, datë 30.09.2024, “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe FSHF-së dhe miratimin e financimit të FSHF-së për ndërtimin e Stadiumit Besa, si dhe dhënien e autorizimit të Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e saj”.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të pozicionit financiar të Bashkisë Kavajë, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

		Lekë
Aktivët Neto janë të barabarta me Aktivët - Pasivë = Aktivët Neto		8,729,046,383
Aktivët		9,674,410,739
Pasivët		945,364,356
Aktivët Neto		8,729,046,383

		Lekë
Aktivët Afatshkurtra më datë 31.12.2024		3,270,605,150
Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”		1,475,622,222
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”		30,558,347
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”		1,764,424,581

A. AKTIVET

I. Aktivët Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

					Lekë
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023	
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0	
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0	
520	Disponibilitete në thesar	1,457,605,672	772,025,004	685,580,668	
50	Letra me vlerë	16,550	1,242,000	(1,225,450)	
532	Vlera të tjera	0	0	0	
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0	
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0	
Totali		1,457,622,222	773,267,004	684,355,218	

- **Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”** paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 772,025,004 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 1,457,605,672 lekë. Kjo llogari kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 1,309,270,107 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 148,335,565 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pikat 49-50.

- **Llogaria 50 “Letra me vlerë”** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 1,242,000 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 16,550 lekë me një pakësim në vlerën 1,225,450 lekë e cila përfaqëson letrat me vlerë konkretisht pullat e Gjendjes Civile.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

					Lekë
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023	
31	Materiale	2,700,686	20,194,738	(17,494,052)	
32	Inventar i imët	27,857,661	25,001,554	2,856,107	
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0	
34	Produkte	0	0	0	
35	Mallra	0	0	0	
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0	
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0	
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0	
39	Provizjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0	
Totali		30,558,347	45,196,292	(14,637,945)	

- Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 30,558,347 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 2,700,686 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 27,857,661 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 14,637,945 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 14,637,945 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 4.1.

- **Llogaria 31 “Materiale”**, ka vlerën 2,700,686 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2024		20,194,739
Shtesa (K)		127,090,253
Pakësime (D)		144,584,304
Gjendja në 31.12.2024		2,700,686

- **Llogaria 32 “Inventarë i imët”**, ka vlerën 27,857,661 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2024		25,001,554
Shtesa (K)		2,856,107
Pakësime (D)		0
Gjendja në 31.12.2024		27,857,661

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023	Lekë
	Llogari të arkëtueshme				
411	Klientë e llogari te ngjashme	6,613,237	2,872,258	3,740,979	
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	91,540,628	91,540,628	0	
431	Tatime e taksa	0	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0	
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0	
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0	
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0	
44	Institucione të tjera publike	0	0	0	
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0	
468	Debitorë te ndryshëm	879,878,586	747,814,846	132,063,740	
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	786,392,130	800,238,041	(13,845,911)	
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0	
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0	
	Totali	1,764,424,581	1,642,465,773	121,958,808	
	Të tjera aktive afatshkurtra				
409	Parapagime	0	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0	
	Totali	0	0	0	

- Gjendja e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,872,258 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 6,613,237 lekë me një rritje në vlerën 3,740,979 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 411 “Klientë e llogari te ngjashme”			Lekë
Çelje e vitit 2024			2,872,258
Shtesa (K)			9,484,825
Pakësime (D)			2,871,588
Gjendja debitore në 31.12.2024			6,613,237

Llogaria 411 “Klientë e llogari te ngjashme”								Lekë
Emërtimi	2019	2020	2021	2022	2023	Totali		
Çerdhja	40,560	212,621	217,971	210,180	211,249	892,581		
Kopshti	294,105	468,935	471,491	208,041	537,105	1,979,677		
Totali	334,665	681,556	689,462	418,221	748,354	2,872,258		

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Në gjendjen e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” janë përfshirë detyrimet që kanë Çerdhet dhe Kopshtet e qytetit ndaj institucionit në vlerën 2,872,258 lekë. Për diferencën në vlerën prej 3,740,979 lekë e pasqyruar në bilanc është e paanalizuar, me ndikim në informacionin

kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie. Llogaria 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitore të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në kredi të llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 4.2, “Të ardhurat në NjQP dhe operacione që lidhen me to”.

- Gjendja e llogarisë 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 91,540,628 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 91,540,628 lekë pra kjo llogari nuk ka shtesa apo pakësime. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”		Lekë
Çelje e vitit 2024		91,540,628
Shtesa (K)		0
Pakësime (D)		0
Gjendja debitore në 31.12.2024		91,540,628

Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 91,540,628 lekë është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 3.2, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 5 “Llogaritë financiar”.

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 747,814,846 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 879,878,586 lekë me një rritje në vlerën 132,063,740 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2024		747,814,846
Shtesa (K)		136,860,727
Pakësime (D)		4,796,987
Gjendja debitore në 31.12.2024		879,878,586

Përmbledhësja e Debitorëve		Lekë
Nr.		Gjendja 01.01.2024
1	Njësia Kavajë	132,652,711
2	Njësia Golem	569,078,110
3	Njësia Synej	52,037,564
4	Njësia Luz	30,276,897
5	Njësia Helmas	41,949,954
6	Drejtoria e Kadastrës	9,036,683
7	Drejtoria e Konsumatorit dhe Mjedisit	15,296,667
8	IVTM	29,550,000
Totali		879,878,586

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë të përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Me shkresën nr. 1214 prot., datë 17.03.2025, Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit mbi borxhin tatimor progresiv më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 879,878,586 lekë pa përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Këto veprime janë në kundërshtim nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

Si dhe nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 7.

- Gjendja e llogarisë 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 800,238,041 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 786,392,130 lekë me një pakësim në vlerën 13,845,911 lekë. Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 3,691,652 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 41,755,233 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 3,381,984 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 12,516,808 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 1,731,737 lekë, 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë” në vlerën 16,550 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 723,298,166 lekë ku totali shkon në vlerën 786,392,130 lekë e cila kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 786,392,130 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	II. Aktive Afatgjata	3,709,379,772	7,380,716,112	(3,671,336,340)
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	100,216,079	125,701,505	(25,485,426)
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	100,216,079	125,701,505	(25,485,426)
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
21	2. Aktive Afatgjata materiale	3,609,163,693	3,698,329,696	(89,166,003)
210	Toka, Troje, Terene	35,999,570	35,121,363	878,207
211	Pyje, Plantacione	10,971,000	10,971,000	0
212	Ndërtesa e konstruksione	1,121,248,594	1,112,080,616	9,167,978
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	2,288,008,290	2,405,231,778	(117,223,488)
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	18,068,088	5,504,354	12,563,734
215	Mjete transporti	64,294,833	41,728,542	22,566,291
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	70,573,317	87,692,043	(17,118,726)
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	114,738,490	713,829,000	(599,090,510)
25	Huadhënie e nënhuadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	114,738,490	713,829,000	(599,090,510)
	4. Investime	2,597,687,328	2,842,855,911	(245,168,583)
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	2,597,687,328	2,842,855,911	(245,168,583)

1. Aktivët Afatgjata Jomateriale

- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 125,701,505 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 7,555,680 lekë, pakësim në vlerën 14,185,880 lekë amortizim të akumuluar në vlerën 18,855,226 lekë ndërsa më datë 31.12.2024,

gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 100,216,079. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 1.) në pasqyrën si më poshtë:

			Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	125,701,505
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	Gjendja në 01.01.2024	125,701,505
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	7,555,680
	5	Amortizim i shtesës	18,855,226
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	14,185,880
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	119,071,305
	5	Amortizim i akumuluar	18,855,226
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	100,216,079

Vlera e mbetur në fund të vitit 2024 prej 122,396,352 lekë (që i përket kostos historike) e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për projekt-studime të pa analizuara për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik. Për këto vlera duhet të detajohen sipas investimeve dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II, Aneksi 1, pika 2, klasa 2, dhe pika 5.

2. Aktivët Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 35,121,363 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 878,207 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 35,999,570. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

			Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	35,999,570
	2	Amortizim i akumuluar	878,207
	3	Gjendja në 01.01.2024	35,121,363
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	878,207
	4	Kosto historike	35,999,570
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	35,999,570

Nga auditimi u konstatua se në gjendjen e llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” është kryer si veprim sistemues, pakësim në vlerën 878,207 lekë që i përket aplikimit të normës së amortizimit për këtë llogari për vitin 2023 në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivët afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pika 30. Ndërkohë që sistemimi i vlerës prej 878,207 lekë referuar trajtimit kontabël duhej t’i shtohet vlerës së aktivitetit dhe jo të kryej pakësimi i vlerës së amortizimit. Sipas informacionit kontabël llogaria 210 “Toka, troje, terrene” është nënvlerësuar në vlerën 878,207 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 36.

- **Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 10,971,000 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë

31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,971,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione"		
		Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		10,971,000
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2024		10,971,000
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		10,971,000
	5	Amortizim i akumuluar		0
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		10,971,000

Për sa trajtuar më sipër llogaria 210 "Toka, troje, terrene" e pasqyruar në bilanc për vlerën 35,121,363 lekë dhe llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" në vlerën 10,971,000 lekë, janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, "Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale" i përmirësuar, Kapitulli "Trajtimi kontabël për aktivet afatgjata të investuara", pikat 47-54, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26-30.

- **Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione"** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 1,112,080,616 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 68,181,062, pakësime në vlerën 16,997,351 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 191,442,166 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,121,248,594 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në *Aneksin nr. 1, Tabela nr. 2.*) në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione"		
		Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		1,261,507,049
	2	Amortizim i akumuluar		149,426,433
	3	Gjendja në 01.01.2024		1,112,080,616
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		68,181,062
	5	Amortizim i shtesës		59,013,084
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		16,997,351
	7	Amortizim nga pakësimet		16,997,351
	4	Kosto historike		1,312,690,760
	5	Amortizim i akumuluar		191,442,166
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		1,121,248,594

- **Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 2,405,231,778 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 3,198,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 1,149,937,130 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,288,008,290 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në *Aneksin nr. 1, Tabela nr. 3.*) në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore"		
		Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		3,434,747,420
	2	Amortizim i akumuluar		1,029,515,642
	3	Gjendja në 01.01.2024		2,405,231,778
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		3,198,000
	5	Amortizim i shtesës		120,421,489
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		3,437,945,420
	5	Amortizim i akumuluar		1,149,937,130
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		2,288,008,290

a. Në gjendjen e llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 1,312,690,760 lekë kosto historike është përfshirë vlera 263,494,134 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në

gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (në formë tabelore në programin E.) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Pjesë e analizës së kësaj llogarie janë kontabilizuar 5 objekte pa vlerë me emërtimin “Njësia Administrative Golem”; “Shkolla 9 vjeçare Golem”; “Shkolla 9 vjeçare Qerret”; “Shkolla 9 vjeçare Kanaparaj”; “Shkolla 9 vjeçare Karpen”.

b. Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,437,945,420 lekë kosto historike është përfshirë vlera 569,988,759 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (në formë tabelore në programin E.) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

c. Në gjendjen e llogarisë 215 “Mjete transporti” në vlerën 154,454,921 lekë kosto historike është përfshirë vlera 29,552,098 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (në formë tabelore në programin E.) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30. Në mënyrë të përmbledhur të dhënat paraqiten si më poshtë:

Lekë				
Llogaria	Luz i Vogël	Golem	Synej	Totali
212 “Ndërtesa e konstruksione”	168,032,051	12,176,243	83,285,840	263,494,134
213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”	218,684,174	82,563,335	268,741,250	569,988,759
Totali	386,716,225	94,739,578	352,027,090	833,482,893

- **Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 5,504,354 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 17,080,756 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 40,365,275 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 18,068,088 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë				
Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”		
		Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		41,352,607
	2	Amortizim i akumuluar		35,848,253
	3	Gjendja në 01.01.2024		5,504,354
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)		17,080,756
	5	Amortizim i shtesës		4,517,022
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		58,433,363
	5	Amortizim i akumuluar		40,365,275
	6	Gjendja më datë 31.12.2024		18,068,088

- **Llogaria 215 “Mjete transporti”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 41,728,542 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 38,640,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 90,160,088 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 64,294,833 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 4.) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë				
Referenca	Nr.	Llogaria 215 “Mjete transporti”		
		Objekte inventari		
	1	Kosto historike		115,814,921
	2	Amortizim i akumuluar		74,086,379
	3	Gjendja në 01.01.2024		41,728,542

Ditari i veprimeve	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	38,640,000
	5	Amortizim i shtesës	16,073,708
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	154,454,921
	5	Amortizim i akumuluar	90,160,088
6	Gjendja më datë 31.12.2024	64,294,833	

- **Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 87,692,043 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 524,604 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 86,574,832 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 70,573,317 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	156,623,545
	2	Amortizim i akumuluar	68,931,502
	3	Gjendja në 01.01.2024	87,692,043
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	524,604
	5	Amortizim i shtesës	17,643,329
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	157,148,149
	5	Amortizim i akumuluar	86,574,832
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	70,573,317

- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” është përlloritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2024, në vlerën 86,574,832 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 “Pajisje kompjuterike” nga aktivet e llogarisë bazë 218 “Inventar ekonomik” e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 36.

- **Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 713,829,000 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur pakësime në vlerën 559,090,510 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 114,738,490 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë
Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”		
Çelje e vitit 2024		713,829,000
Shtesa (K)		0
Pakësime (D)		559,090,510
Gjendja debitore në 31.12.2024		114,738,490

Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Kavajë me Nipt J..... është 653,394,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës me Nipt M..... Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Kavajë sipas Marrëveshjes “Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Durrës” me nr. 1567 prot., datë 25.07.2022, është 55,538,490 lekë ose 8.5% ($8.5\% * 653,394,000 = 55,538,490$ lekë). Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Futboll Club Besa me Nipt K.....A është 160,000,000 lekë. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Kavajë është 59,200,000 lekë ose 37% ($37 * 16,000,000 / 100 = 59,200,000$ lekë). Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 114,738,490 lekë e kontabilizuar saktë, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 31.

4. Investimet

Gjendja e llogarisë 231 “Për aktivet afatgjata materiale” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,842,855,911 lekë. Për këtë llogari nuk disponohet informacion mbi shtesat dhe pakësimet e kësaj llogarie, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,597,687,327 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”		Lekë
Gjendje në 01.01.2024		2,842,855,911
Shtesa (K)		Nuk ka informacion
Pakësime (D)		Nuk ka informacion
Gjendja në 31.12.2024		2,597,687,327

Të dhënat e çeljes së llogarisë më datë 31.12.2023, paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i objektit	Operatori ekonomik	Vlera e faturës
1	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Bago paradhënie	G.	28,481,857
2	Rikonstruksion i kopështit Hap pas Hapi paradhënie	G.	8,475,000
3	Furnizim me ujë në zonat bregdetare	B.	9,310,560
4	Rehabilitim i ndriçimit Rrugor me sistemin LED	B.	1,559,604
5	Rehabilitim i ndriçimit Rrugor me sistemin LED	B.	6,000,000
6	Rikonstruksion i çerdhes Nektari i Jetës	J. Shpk	1,952,050
7	Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës për furnizim me ujë faza 2 likuidim total	G..	44,001,915
8	Rikonstruksion i rrugës së Cetes	N.	2,270,400
9	Rikonstruksion i rrugëve të Qytetit	B. Shpk	2,661,260
10	Rehabilitim dhe sistemin i varrezave publike	F. Shpk	2,000,000
11	Blerje fidanë pemë dekorative	Gj...	5,145,000
12	Rikonstruksion Shkolla 9 vjeçare Qamil Xhani	S. Shpk	32,414,715
13	Furnizim me ujë në zonat bregdetare Situacion 9	B.	9,475,004
14	Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës furnizim me ujë qyteti Kavajë dhe depo uji faza 2	G...	51,427,200
15	Riparim impianti i ujrave të zeza Kavajë Ujësijellësi Luz	A. C.	393,120
16	Rindërtim Kopësht Çerdhe Luz i Vogël	M. Shpk	7,851,319
17	Rindërtim Kopësht Çerdhe Luz i Vogël	N...	8,171,781
18	Rindërtimi i godinës së ish-Nënprefekturës	Ll. Shpk	25,043,354
19	Rikonstruksion i Kopështit Hap pas Hapi	G.	24,441,169
20	Rikualifikim i rrugës kryesore fshatit Qerret Kavajë	K...	1,308,372
21	Rehabilitim i sinjalistikës së qytetit Kavajë	R...	11,524,800
22	Rindërtimi i kopështit Çerdhe në fshatin Golem Paradhënie punimesh	I. C.	31,291,000
23	Furnizim me ujë në zonat bregdetare Situacion 10 pjesor	B.	2,105,264
24	Riforcimi i njësive individuale të banimit DS4 Faza 1 Situacion nr. 1	G...	29,847,63
25	Furnizim me ujë në zonat bregdetare Situacion pjesor 10	B.	1,054,000
26	Rehabilitim i sinjalistikës Kavajë situacioni 2 përfundimtar	R...	3,180,000
27	Furnizim me ujë zonat bregdetare situacioni pjesor nr. 10	B.	1,055,000
28	Rikonstruksion i kopshtit Hap pas Hapi	G.	16,592,242
29	Rehabilitim i ndriçimit Rrugor me sistemin LED situacioni nr. 4	B.	3,170,100
30	Furnizim me ujë zonat bregdetare Plazhi i Gjeneralit, Bardhor, Karpen, Synej	B.	2,635,291
31	Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës furnizim me ujë qyteti Kavajë dhe depo uji faza 2 situacioni nr. 4	G...	99,850,600
32	Rehabilitim i ndriçimit rrugor me sistemin LED situacioni nr. 5	B.	4,348,120
33	Furnizim me ujë në zonat bregdetare plazhi i Gjeneralit Bardhor-Karpen Synej situacioni nr. 11	B.	7,827,786
34	Riparim impianti i ujrave të zeza Kavajë Ujësijellësi Luz	A. C.	19,606,880
35	Riforcim i njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa	G..	150,086,475
36	Furnizim me ujë zonat Bregdetare, situacioni nr. 12	B.	7,959,550
37	Rindërtimi i Godinës së Bordit të Kullimit situacioni nr. 1	Sh.	17,794,165
38	Rindërtimi i Godinës së Bordit të Kullimit situacioni nr. 2	Sh.	57,180,000
39	Rindërtim i stacionit Zjarrfikës situacioni nr. 1	G. C.	22,583,549
40	Rindërtim i godinës së Bordit të Kullimit situacioni nr. 3 pjesor	Sh.	31,000,000
41	Riforcim i njësive të banimit DS4 qyteti Kavajë situacioni nr. 2	G. C.	125,221,249
42	Riforcim i njësive të banimit DS4 qyteti Kavajë situacioni nr. 3	G. C.	142,645,550
43	Rikonstruksion i linjave të puseve Situacioni Përfundimtar	B.	4,447,276
44	Rindërtimi i stacionit zjarrfikës situacioni nr. 2	G. C.	22,000,000
45	Rindërtimi i stacionit zjarrfikës situacioni nr. 3	G. C.	8,006,666
46	Rindërtimi i Godinës së ish-Nënprefekturës	Ll. Shpk	8,347,785
47	Riforcimi i njësive individuale të banimit ndërtesa pallat faza 1 situacioni nr. 1	G. C.	85,003,084
48	Riforcimi i njësive individuale të banimit ndërtesa pallat faza 1 situacioni nr. 2	G. C.	69,740,019
49	Riforcimi i njësive individuale të banimit ndërtesa pallat faza 1 situacioni nr. 3	G...	31,580,400
50	Blerje pajisje elektroshtëpiake	I. T.	73,000
51	Blerje karrige zyre	C. C.	96,000
52	Blerje mjete transporti	K. T.	7,140,000
53	Shpronësime unaza lindore Eqrem Maliqati		348,525
54	Shpronësime unaza lindore Mynyr Maledhi		390,348
55	Shpronësime unaza lindore Nazmi Kuqi		1,394,100
56	Shpronësime unaza lindore per Bujar Halit Dimni		1,414,787
57	Shpronësime Unaza Lindore Ardian Rexhep Gjoci		1,590,307
58	Shpronësime Unaza Lindore Bujar Halit Dimni		943,742
59	Shpronësime Unaza Lindore Bujar Halit Dimni		2,385,460
60	Shpronësime unaza lindore Dëfrim Sheshi		116,175
61	Shpronësime unaza lindore Kavajë për Eqerem Sheshi		1,208,220

62	Mbikqyrje punimesh shkolla Razi Leka	C. G.	956,148
63	Mbikqyrje punimesh me objekt Rikonstruksion i Shkollës Qamil Xhani	C. G.	837,262
64	Mbikqyrje punimesh rikonstruksion i rrjetit shpërndarës dhe ndërtim depo faza 2	A..	500,000
65	Mbikqyrje punimesh Rehabilitim i Shkollës së Mesme Aleksandër Moisiu	M. K.	339,600
66	Kolaudim vazhdim punimesh rikonstruksion Shëtitore nr. 2	M. K.	30,000
67	Mbikqyrje Ndërtimi i Shkollës 9 vjeçare Qerret Kavajë	M. K.	90,908
68	Mbikqyrje punimesh rikonstruksion i rrugës kla-xhu shëtitore Golem	A.... Shpk	696,000
69	Mbikqyrje punimesh rikonstruksion i rrugës Fragment i shëtitores nr. 1 nga Teqja rruga dalje	A.... Shpk	672,000
70	Mbikqyrje punimesh furnizim me ujë në zonat bregdetare	C...	400,000
71	Mbikqyrje punimesh per rikonstruksion i kopshtit Hap pas Hapi	C...	464,643
72	Kolaudimi i punimeve të ndërtimit me objekt Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi	G..	307,641
73	Mbikqyrje Riforcimi i njëjve individuale dhe pallateve DS4	T. Shpk	2,419,000
74	Mbikqyrje punimesh Rikonstruksion i linjave të puseve	D. Shpk	315,428
75	Mbikqyrje punimesh Rikonstruksion i linjave të puseve	D. Shpk	94,219
76	Hartim projektim rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Bago	C..	883,520
77	Hartim projektim i zbatimit të rindërtimit kopësht çerdhe Golem	C..	891,561
Totali			1,287,219,125

Të dhënat e çeljes së llogarisë më datë 31.12.2023, paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë			
Nr.	Emërtimi i objektit	Operatori ekonomik	Vlera e faturës
1	Rindërtimi i ish-Nënprefekturës situacioni numër 1	LI. SHPK	166,955,697
2	Rehabilitimi i ndriçimit rrugor	B.	73,646,400
3	Rindërtimi i kopësht çerdhe në fshatin Golem	I.	208,808,602
4	Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare Qamil Xhani	S.	137,000,000
5	Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare Razi Leka	B.	116,138,694
6	Rindërtimi i kopësht çerdhe Luz Situacioni 1	N..	106,820,667
7	Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare Bago	G.	189,879,050
8	Rikonstruksion i kopshtit Hap pas Hapi	G.	56,544,778
9	Rikonstruksion i Bordit të Kullimit	Sh.	145,250,480
10	Rikonstruksion i godinës së Zjarrfikësave	G. K.	77,663,390
11	Riforcim	G..	594,114,139
12	Riforcim	Sh.	528,834,954
13	Furnizim me ujë në zonat bregdetare	B.	188,549,796
14	Rehabilitimi i sinjalistikës	R..	7,471,680
Totali			2,597,687,327

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Nga auditimi u konstatua se, nuk dokumentohet pakësimi i 77 objekteve në gjendjen e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” në vlerën 1,287,219,125 lekë pra shpërndarja e tyre në aktiv. Ndërkohë që shtesa për vitin 2024 në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” është 68,181,062 lekë dhe 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është 3,198,000 lekë. Për më tepër nuk disponohet analiza për vlerën 1,555,636,786 lekë të mbetur të çeljes së datës 01.01.2024. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi nr. 1, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata (Përbërja dhe trajtimi kontabël)”.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 2,597,687,327 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 2,597,687,327 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, gërma “c”.

- Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, makineri pajisje vegla pune”, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në

kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total **3,176 pasuri** si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **2,645 pasuri në pronësi** dhe **531 pasuri në përdorim** si më poshtë:

➤ **Bashkia Kavajë:**

- Me VKM-në nr. 1563, date 26.11.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kavajë, të Qarkut të Tiranë”, është miratuar lista inventarit me në total **690 pasuri nga të cilat 655 pasuri në pronësi dhe 34 pasuri në përdorim**. Kjo listë fillon me numër 1 dhe mbaron me numër 690 dhe përbëhet me 112 fletë.

➤ **Ish-Komuna Helmës sot Njësia Administrative Helmës e Bashkisë Kavajë:**

- Me VKM-në nr. 5, datë 06.01.2013, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Helmas, të Qarkut të Tiranë”. Lista me 100 fletë dhe përfundon me numër rendor 702, është miratuar lista inventarit me **702 pasuri total** nga të cilat **419 pasuri në pronësi** dhe **283 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komuna Synej sot Njësia Administrative Synej e Bashkisë Kavajë:**

- Me VKM-në nr. 45, datë 19.01.2011, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Synej, të Qarkut të Tiranë”. Lista me 82 fletë dhe përfundon me numër rendor 584, është miratuar lista inventarit me **584 pasuri total** nga të cilat **401 pasuri në pronësi** dhe **183 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komuna Golem sot Njësia Administrative Golem e Bashkisë Kavajë:**

- Me VKM-në nr. 370, datë 30.01.2013, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Golem, të Qarkut të Tiranë”. Lista me 110 fletë dhe përfundon me numër rendor 773, është miratuar lista inventarit me **773 pasuri total** nga të cilat **752 pasuri në pronësi** dhe **21 pasuri në përdorim**.

➤ **Ish-Komunës Luz i Vogël sot Njësia Administrative Luz i Vogël:**

- Me VKM-në nr. 4, datë 06.01.2011, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Luz i vogël, të Qarkut të Tiranë”. Lista me 66 fletë dhe përfundon me numër rendor 427, është miratuar lista inventarit me **427 pasuri total** nga të cilat **417 pasuri në pronësi** dhe **10 pasuri në përdorim**.

- **Pyjet dhe Kullotat**, në bazë të VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, i ndryshuar sipërfaqet pyjore dhe kullosore. Bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti, në tabelën e mëposhtme është pasqyruar numri i pronave sipas listës së inventarit si dhe VKM-ve përkatëse të njësive Administrative dhe të Bashkisë Kavajë.

Tabela përmbledhëse e pronave sipas listës së inventarit:

Nr.	Bashkia/ Njësitë	Nr. i Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2024	Nr. i Praktikave të Certifikuara 2024	Nr. i Praktikave në proces	Nr. i Pronave të pa Regjistruara
1	Bashkia Kavajë	690	106	0	23	567
2	Nj.Ad.Golem	773	55	0	23	724
3	Nj.Ad.Luz i Vogël	427	2	0	6	412
4	Nj.Ad.Synej	584	13	0	4	497
5	Nj.Ad.Helmas	702	25	0	20	645
	Totali	3,176	201	0	76	2,845

Burimi i të dhënave: Bashkia Kavajë.

Shënim: Për pasuritë e llojit “arë”, “pa frute” dhe “pyll”, në VKM rezultojnë të renditura në total si pasuri “mëmë” dhe kur regjistrohen ndahen në pasuri “bija”.

Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total **3,176 pasuri** si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **2,645 pasuri në pronësi** dhe **531 pasuri në përdorim**. Në total në pronësi të

Bashkisë Kavajë janë **2,645** pasuri, nga të cilat **201** pasuri janë të pajisura me çertifikatë dhe **2,444** pasuri nuk janë të pajisura me titull pronësie. Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu III, pika 35 dhe Kreu II, pika 16, neni 37, pika 1, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

- Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Kavajë të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm **106 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie.**

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV neni 37 pika 1, 2, gërmat “a-b”, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që përbërja e anëtarëve të komisioneve për inventarizimin e aktiveve të institucionit mos të jetë e njëjtë me atë të vitit të mëparshëm.

2.2. Rekomandimi: Nga komisionet e inventarizimit të aktiveve, pas përfundimit të procesit të inventarizimit, të paraqitet para nëpunësit autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit.

2.3. Rekomandimi: Nga komisionet për asgjësimin e aktiveve të merren masa që gjatë zhvillimit të procesit të asgjësimit, të respektohen kriteret për mbrojtjen e mjedisit si dhe të dokumentohet i gjithë procesi sipas kriterëve të përcaktuara në dispozitat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Me Urdhrin nr. 355, datë 12.09.2024, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të institucionit i përbërë nga tre punonjës në përpunje me dispozitat ligjore në fuqi. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit me shkresën nr. 4568 prot., datë 31.12.2024, është hartuar raporti për inventarin fizik. Gjithashtu përgjatë vitit 2024 janë nxjerrë

aktive jashtë përdorimit në vlerën 16,997,351 lekë që i përket tre objekteve: “Kopshti Fiqiri Kurti”; “Ndërtesa e stadiumit & muri rrethues” “Ndërtim muri rrethues fusha e vjetër”. Pakësimi nga kontabiliteti i këtyre objekteve është kryer në zbatim të VKB-së nr. 62, datë 29.09.2023, “Për shembjen e detyruar të ndërtesës së kopshtit “Fiqiri Kurti” si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019” dhe VKB-në nr. 49, datë 30.09.2024, “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe FSHF-së dhe miratimin e financimit të FSHF-së për ndërtimin e Stadiumit Besa, si dhe dhënien e autorizimit të Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e saj”.

Rekomandimet nr. 2.1, nr. 2.2 dhe 2.3 janë zbatuar

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 31.12.2024, në vlerën 1,457,605,672 lekë. Kjo llogari kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 1,309,270,107 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 148,335,565 lekë.

Rekomandimi është zbatuar

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike, në pasqyrat financiare të vitit 2024, të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 32 “Inventar i imët” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë, duke kuadruar me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 30,558,347 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 14,637,945 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 14,637,945 lekë.

Rekomandimi është zbatuar

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për analizimin, zbërthimin e dokumentacionit ligjor për diferencën në vlerën 715,446 lekë që i përket çeljes së llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjajshme” me qëllim saktësimin e vlerave në pasqyrat financiare.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Gjendja e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” më datë 31.12.2024, në vlerën 6,613,237 lekë. Për vlerën prej 3,740,979 lekë të kontabilizuar në gjendjen e kësaj llogarie e pasqyruar në bilanc është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie.

Rekomandimi nuk është zbatuar

5.2. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogarinë 423 dhe 429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)” të kontabilizuara në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë hartimit të pasqyrave financiare për vitin 2024, konkretisht llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 91,540,628 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël.

Rekomandimi nuk është zbatuar

5.3. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave, të Ardhurave dhe Borxhit të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468

“Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe për vitin 2024, konkretisht në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë kontabilizuar debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Për më tepër në Pasiv nuk është e pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”, e cila shërben si kundërparti e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Rekomandimi nuk është zbatuar

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 122,396,352 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara, si dhe aplikimin e normës së amortizimit për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” duke përmbushur njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Vlera e mbetur në fund të vitit 2024 prej 122,396,352 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për projekt-studime të pa analizuar për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik.

Rekomandimi nuk është zbatuar

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2024 të bëjë sistemimin e vlerës 878,207 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Në gjendjen e llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” është kryer si veprim sistemues, pakësim në vlerën 878,207 lekë që i përket aplikimit të normës së amortizimit për këtë llogari për vitin 2023 në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pika 30. Ndërkohë që sistemimi i vlerës prej 878,207 lekë referuar trajtimit kontabël duhej t’i shtohet vlerës së aktivitetit dhe jo të kryej pakësimi i vlerës së amortizimit. Sipas informacionit kontabël llogaria 210 “Toka, troje, terrene” është nënvlerësuar në vlerën 878,207 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor të llogarive aktiveve afatgjata të Klasës 20, (210, 212, 213) për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë hartimit të pasqyrave financiare për vitin 2024, konkretisht nuk është bërë zbrërthimi i dokumentacionit financiar për aktivet që i përkasin llogarive 210, 211, 212 dhe 213, të transferuara ndër vite nga ish-komunat drejt Bashkisë Kavajë.

Rekomandimi nuk është zbatuar

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për analizimin, zbrërthimin e dokumentacionit ligjor për diferencën në vlerën 29,552,098 lekë që i përket kostos historike të

llogarisë 215 “Mjete transporti” me qëllim saktësimin e vlerave në pasqyrat financiare dhe në inventarin fizik.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2024, konkretisht në gjendjen e llogarisë 215 “Mjete transporti” në vlerën 154,454,921 lekë kosto historike është përfshirë vlera 29,552,098 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

Rekomandimi nuk është zbatuar

10.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 114,738,490 lekë e kontabilizuar saktë, në të cilën janë të përfshira aksionet e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës dhe Shoqërisë Aksionare Futboll Club Besa.

Rekomandimi është zbatuar

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor të llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” për nxjerrjen e të dhënave për vlerën 1,512,285,441 lekë që i përket investimeve të kryer ndër vite dhe të diferencës ndërmjet çeljes dhe shtesave në vlerën 43,351,345 lekë, për të verifikuar saktësuat e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Nga auditimi u konstatua se, nuk dokumentohet pakësimi i 77 objekteve në gjendjen e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” në vlerën 1,287,219,125 lekë pra shpërndarja e tyre në aktiv. Ndërkohë që shtesa për vitin 2024 në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” është 68,181,062 lekë dhe 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është 3,198,000 lekë. Për më tepër nuk disponohet analiza për vlerën 1,555,636,786 lekë të mbetur të çeljes së datës 01.01.2024.

Rekomandimi nuk është zbatuar

11.2. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për sistemin e vlerës 1,775,081 lekë nga llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të kontratave në proces të projekteve duke i kontabilizuar në llogarinë 230 “Investime për aktivet afatgjata jo materiale”.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 2,597,687,327 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 2,597,687,327 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë

Rekomandimi nuk është zbatuar

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të evidentojë pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 2,597,687,327 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 2,597,687,327 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që kontabilizimi në pasqyrat financiare i aktiveve që i përkasin aktiveve të Klasës 20 të kryhet duke u bazuar në dokumentacion pronësor të pasurisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacioni të vënë në dispozicion u konstatua se, nga Bashkia Kavajë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 3,691,652 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 41,755,233 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 3,381,984 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 12,516,808 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 1,731,737 lekë, 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë” në vlerën 16,550 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 723,298,166 lekë ku totali shkon në vlerën 786,392,130 lekë e cila kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 786,392,130 lekë.

Rekomandimi është zbatuar

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për sistemimin e vlerës 150,519,696 lekë të kontabilizuar gabim në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” duke i kontabilizuar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Nga auditimi u konstatua se, janë kryer veprimet rregulluese duke i kontabilizuar ato në gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Rekomandimi është zbatuar

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për analizimin, zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për diferencën e paraqitur për vlerën 119,989 lekë që i përket llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” me qëllim saktësimin e vlerave në pasqyrat financiare.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” referuar pasqyrave financiare vlera 41,755,233 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës të cilat janë likuiduar sipas urdhër shpenzimeve përkatëse.

Rekomandimi është zbatuar

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të analizojë vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare të llogarisë 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë” të kontabilizuara në vite.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Kjo problematikë u konstatua edhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare për vitin 2024 konkretisht, vlera 16,550 lekë që i përket kësaj llogarie e pasqyruar në bilanc është e paanalizuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për vlerën 118,369,219 lekë të pa analizuar në kontabilitet që i përket llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, me qëllim evidentimin dhe raportin e saktë në dokumentet kontabël të Njesisë.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Për diferencën në vlerën 53,386,933 lekë nga gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 94,948,632 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të kësaj llogarie.

Rekomandimi nuk është zbatuar

18.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Ekonomike të marrin masa për analizimin e përdorimit për interes publik të fondeve që ju ka mbaruar periudha e garancisë, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Brenda datë 31.12.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Për vitin 2024 është likuiduar vlera prej 64,412,863 lekë por mbeten ende 22 projekte të cilat u ka kaluar afati edhe nuk janë likuiduar për pjesën e 5% të garancisë së punimeve.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për sistemimin e vlerës 100,000 lekë e cila ka të bëjë me mos kontabilizimin e të gjithë vlerës sipas analizës përkatëse që i përket detyrimeve që ka institucioni ndaj të tretëve në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Në gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” është kryer kontabilizimi i saktë i faturave ende të pa likuiduara në vlerën totale 723,298,166 lekë.

Rekomandimi është zbatuar

20.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike, të marrë masa për kryerjen e pagesave të planifikuara dhe të papaguara për kredinë e marrë nga Banka Qendrore Evropiane (CEB), në shumën 7,670,516 lekë të bëjë kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të llogarive në mënyrë që pasqyrat financiare të sigurojnë informacion të saktë për pozicionin financiar të kredisë.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Nga auditimi u konstatua se për është kryer pagesa për vitet 2020-2024, në vlerën 24,991,551 lekë sipas Urdhër Shpenzimit nr. 1226, datë 06.08.2024. Ndërsa vlera prej 10,636,66 lekë e mbetur e huasë është e kontabilizuar në gjendjen e llogarisë 16,17,18 “Huatë Afat Gjata” si detyrim për t’u paguar në vijimësi.

Rekomandimi është zbatuar

21.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

Deri më datë 31.03.2025

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 8,049,666,667 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 135,180,102 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 14,637,945 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 31,183,231 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 254,399,416 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 494,125,791 lekë.
Rekomandimi nuk është zbatuar

22.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Ekonomike të marrë masa për kompletimin e dosjes së shpronësimit me dokumentacionin e munguar, konkretisht: çertifikata e pronësisë, akt-marrëveshja midis ASHSH dhe Bashkisë Kavajë, dokumenti për përlllogaritjen e shpronësimit dhe urdhri për komision të posaçëm nga ASHSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar

22.2. Rekomandimi: Bashkia Kavajë, Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë që të kryejë likuidimin e faturave ndaj operatorëve ekonomikë brenda afateve të parashikuara në ligj, për shmangien e krijimit të detyrimeve kontraktore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar

23.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë, Drejtoria e Burimeve Ekonomike në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të institucionit të marrë masa për hartimin e kartelave përkatëse të mjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e mjeteve si dhe të pajisjen me certifikatë pronësie, dokumentin e kontrollit teknik dhe me policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar

23.2. Rekomandimi: Bashkisë Kavajë të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për kryerjen e testeve dhe miratimin e normativave të konsumit të karburantit për mjetet e flotës së institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.
Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.
Rekomandimi nuk është zbatuar

24.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Ekonomike të marrë masa që në çdo rast të shpenzimeve për aktivitete social-kulturore të jenë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, geramat “b” dhe “c” “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” dhe mbështetur në nenet 98-102 të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkisë Kavajë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësisht, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,505,840 lekë** si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Kavajë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 1,505,840 lekë si pasojë e shpenzimit të karburantit në mungesë të dokumentacionit vërtetues dhe justifikues nga shtatë punonjës (*sipas listës në pikën nr. 2.1.*) të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të bashkisë, duke ndjekur gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

C. MASA DISIPLINORE

C.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

C.1.1 PËR PUNONJËSIT TË CILËT JANË PJESË E SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të shkronjës “c” neni 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me Ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kavajë, që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për 1 punonjës të mëposhtëm:

1. Për Znj. F. Gj., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në cilësinë e nëpunësit zbatues, nënshkrues i pasqyrave financiare, për shkeljet:

- Për depozitim të pasqyrave financiare jashtë afatit ligjor në Degën e Thesarit;
- Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 182,845,257 lekë;
- Për mos kuadrimit të diferencës së lëvizjes së inventarit në vlerën 7,531,853 lekë me llogarinë 63

“Ndryshimi i gjendjes së inventarit”;

- Për mos kontabilizimin e saktë të çeljes së llogarisë 411 *“Klientë e llogari të ngjashme”* me një diferencë në vlerën 715,446 lekë;
 - Për kontabilizimin e vlerës 91,540,628 lekë që i përket llogarisë 423,429 *“Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)”* e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie;
 - Për mos kontabilizimin e debitorëve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në llogarinë 468 *“Debitorë të ndryshëm”;*
 - Vlera e mbetur në fund të vitit 2022 prej 122,396,352 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 *“Studime dhe kërkime”*, për projekt-studime të pa analizuara për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme;
 - Për llogarinë 202 *“Studime dhe kërkime”* nuk është përlllogaritur normë amortizimi.
- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”* konstatohet se, për llogarinë 210 *“Troje, toka, terrene”* është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 878,207 lekë;
- Llogaria 210 *“Toka, troje, terrene”* e pasqyruar në bilanc për vlerën 35,121,363 lekë dhe llogaria 211 *“Pyje, kullota, plantacione”* në vlerën 10,971,000 lekë, janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari;
 - Në gjendjen e llogarisë 212 *“Ndërtesa e konstruksione”* në vlerën 1,261,507,049 lekë kosto historike është përfshirë vlera 263,494,134 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (*në formë tabelore në programin E.*) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit;
 - Në gjendjen e llogarisë 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* në vlerën 3,434,747,420 lekë kosto historike është përfshirë vlera 569,988,759 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë (*në formë tabelore në programin E.*) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit;
 - Nga auditimi i të dhënave analitike progresive të llogarisë 215 *“Mjete transporti”* më datë 31.12.2023, gjendja e aktiveve të kësaj llogarie paraqitet në vlerën 86,262,823 lekë, ndërkohë që nga të dhënat e kontabilizuara në Pasqyrën nr. 7/b, *“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata neto (Vlera neto)”* mbyllja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 115,814,921 lekë kosto historike me një diferencë në vlerën 29,552,098 lekë.
 - Llogaria 26 *“Pjesëmarrje në kapitalet e veta”*, është mbivlerësuar në vlerën 599,090,510 lekë;
 - Llogaria 230 *“Investime për aktivet afatgjata jo materiale”* është nënvlerësuar në vlerën 1,775,081 lekë;
 - Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 *“Investime për aktive afatgjata jo materiale”* paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 *“Investime për aktive afatgjata materiale”* në vlerën 2,842,855,911 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 2,842,855,911 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 *“Nga fondet e veta të investimeve”* e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 *“Teprica e grondeve kapitale të brendshme”* në vlerën 0 lekë;
 - Përmbledhësja e llogarive 401-408 *“Furnitorë e llogari të lidhura me to”* paraqitet në vlerën 33,232,495 lekë, 42 *“Detyrime ndaj personelit”* në vlerën 30,181,721 lekë, 431 *“Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”* në vlerën 1,748,837 lekë, 435 *“Sigurime shoqërore”* në vlerën 8,872,253 lekë, 436 *“Sigurime shëndetësore”* në vlerën 1,221,466 lekë, 464 *“Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë”* në vlerën 1,242,000 lekë dhe 467 *“Kreditorë të ndryshëm”* në vlerën

724,981,269 lekë ku totali shkon në vlerën 801,480,041 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 800,238,041 lekë.

-Në gjendjen e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është përfshirë vlera prej 150,519,696 lekë e përbërë nga vendime gjyqësore në vlerën 45,616,172 lekë + mallra dhe shërbime në vlerën 21,660,099 lekë + investime në vlerën 83,243,425 lekë të cilat duhet të kontabilizohen në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”;

- Vlera e detyrimeve më datë 31.12.2023, për llogarinë 42 “Detyrime ndaj personelit” sipas udhër shpenzimeve dhe akt-rakordimit me Degën e Thesarit Kavajë është në vlerën 30,061,732 lekë ndërsa në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 30,181,721 lekë me një diferencë në vlerën 119,989 lekë;

- Llogaria 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 1,242,000 lekë është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie;

- Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk paraqitet e saktë për arsye se, në analizat përkatëse vlera e kreditorëve është 725,081,269 lekë ndërsa në bilanc në vlerën 724,981,269 lekë me një diferencë mos kontabilizimi në vlerën 100,000 lekë;

- Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është mbivlerësuar në vlerën 1,536,878,023 lekë;

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

2.3.1. Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 20 ditor. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j”, ku përcaktohet që:

j) të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, ku përcaktohet që:

Pika 2. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Kavajë administruar në KLSH me nr. 34/17 prot., datë 05.06.2024, janë rekomanduar gjithsej:

- 22** masa organizative;
- 4** masa për shpërbllim dëmi në vlerën **43,468,061** lekë;

- 15** masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash;
- 1** masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet të fondeve publike;
- 1** masë disiplinore;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	22	22	0
Masa për shpërblim dëmi	4	4	0
Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash	43,468,061	43,468,061	0
Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet të fondeve publike	15	15	0
Masa disiplinore	1	1	0
Totali	43	43	0

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Kavajë:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	22	1	3	14	4
Masa për shpërblim dëmi	4	0	0	2	2
Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash	43,468,061	0	0	2	2
Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet të fondeve publike	15	1	4	5	5
Masa disiplinore	1	0	0	1	0
Totali	43	2	7	22	12
Totali në %	100%	4.6%	16.3%	51.2%	27.9%

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, Koordinatori i Riskut dhe Koordinatori i MFK - së të marrë masa për:

- Përditësimin e rregullores së brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore të institucionit.
 - Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performance, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
 - Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin e konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.
 - Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.
- Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

Menjëherë dhe në vijimësi

<p>Statusi i rekomandimit: I pranuar.</p> <p>Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua e njëjta problematikë edhe për vitin 2024, konkretisht nuk ka përditësim të rregullores së brendshme të institucionit pra është e vitit 2024, nuk është hartuar strategjia e riskut, regjistri i riskut dhe gjurmët e auditimit.</p> <p>Rekomandimi nuk është zbatuar</p>

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të merren masa për:

- Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, si një organ i pavarur.
- Përditësimin e Kartës së Auditimit dhe Programit për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese,
- Shqyrtimin e risqeve më të rëndësishëm për planifikimin dhe zbatimin e projekteve, programeve në të cilat janë fokusuar objektivat strategjike, të njësive publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Nuk disponohet urdhër për ngritjen e Komitetit. Ka hartuar kartën e auditimit të brendshëm me shkresën nr. 7961 prot., datë 07.02.2024.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të miratojë udhëzimin e brendshëm të përgatitjes së buxhetit i cili të shpërndahet te secili drejtues i EMP (DEMP), dhe të përmbajë, listën e programeve buxhetore, përcaktimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit të programeve, tavanet përgatitore për çdo program për tre vitet e ardhshme, afate të detajuara për EMP lidhur me përgatitjen e kërkesave për shpenzime sipas programeve të PBA-së. Të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Kavajë. Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kavajë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar të dhënave të aktrakordimit të shpenzimeve për vitin 2024, u konstata se planifikimi vjetor ka qenë në vlerën 3,260,717,273 lekë ndërsa realizimi në vlerën 2,240,806,380 lekë në masën 68.7% ose me një mosrealizim në vlerën 1,019,910,893 lekë. Pra edhe për këtë vit evidentohet diferenca në realizimin e planit buxhetor i cili vjen si rezultat i një planifikimi jo të saktë.

Rekomandimi është në proces zbatimi

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe GMS të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore/nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim zvogëlimin e detyrimeve të prapambetura.

Të përgatitet një plan për daljen nga situata e vështirë financiare dhe të raportohet në Këshillin Bashkiak në mënyrë periodike gjendja e faturave të pa likuiduara të prapambetura si dhe të hartohet një grafik likuidimi, sipas datës së krijimit të detyrimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Pagesat për vitin 2024 në lidhje me detyrimet e prapambetuara është në vlerën 9,477,139 lekë dhe vlera prej 32,633,145 lekë që i përkasin llogarive 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe 467 "Kreditorë të ndryshëm".

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

5.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa që strukturat e ngarkuara për administrim të taksave dhe tarifave vendore sipas paketës fiskale, të japin informacion të plotë në DTTVAB lidhur me planifikimin, realizimin dhe ndjekjen e subjekteve debitorë për të gjitha taksat/tarifat vendore dhe gjobat e aplikuara për kundërvajtjet administrative. Gjithashtu, të rishikohet paketa

fiskale duke parashikuar taksa e tarifa për të gjitha kategoritë e biznesit që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Me Vendimin nr. 63, datë 06.12.2024, të Këshillit Bashkiak Kavajë, me objekt "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 në Bashkinë Kavajë". Në këtë dokument janë kryer përditësimet duke u përfshirë taksat dhe tarifavat vendore për kategoritë: ATM-të; Pullat e Gjendjes Civile; Tarifavat për mbrojtjen nga zjarri dhe azhurnimi i gjobave. Për sa i përket TNI, nuk është paraqitur informacion pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

6.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa për ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit bazuar në të gjithë elementët e tij, (mjedisin i sigurisë së informacionit, vlerësimi i riskut, politikat e sigurisë, organizimi i sigurisë së TIK, menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, menaxhimi i aseteve, siguria e burimeve njerëzore, siguria fizike dhe mjedisore, kontrolli i aksesit, menaxhimi i incidenteve të sigurisë së tik, menaxhimi i vazhdueshmërisë së aktivitetit të njësisë, përputhshmëria.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

7.1. Rekomandimi: DTTVAB të kryej inventarizimin e të gjithë subjekteve të cilët janë objekt i taksave vendore dhe të plotësohet një regjistër me të dhënat përkatëse, të plotësohen dosjet e subjekteve me dokumente që informojnë në mënyrë kronologjike veprimtarinë e tatimpaguesit, të tilla si kartela të viteve të kaluara, pagesat nga bankat, llogaritjet e xhiros, akt verifikimet e inspektorëve, të dhëna për aplikimin e gjobave, lloje të ndryshme dokumentesh të pronësisë etj.,.

-Të ushtrohet kontroll në subjekte për llogaritjen e detyrimeve tatimore, mbajtjen e regjistrave dhe kryerjen e pagesave të tatimeve në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin tatimor.

-Të evidentojë subjektet që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të merren masat përkatëse ligjore për regjistrimin e tyre dhe llogaritjen e arkëtimit të detyrimeve përkatëse vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Me Vendimin nr. 63, datë 06.12.2024, të Këshillit Bashkiak Kavajë, me objekt "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 në Bashkinë Kavajë". Në këtë dokument janë kryer përditësimet duke u përfshirë taksat dhe tarifavat vendore për kategoritë: ATM-të; Pullat e Gjendjes Civile; Tarifavat për mbrojtjen nga zjarri dhe azhurnimi i gjobave.

Rekomandimi është zbatuar

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që me grup pune, specialist të fushës, të hartojë regjistrin e plotë të aktiveve, jo vetëm për ato që janë të regjistruara në kontabilitet, por edhe për aktivet të cilat momentalisht nuk janë të regjistruara në librat e kontabilitetit. Të bëhet inventarizimi fizik i të gjitha pasurive në teren dhe për situatën e konstatuar të hartohet një raport i hollësishëm titullarit të institucionit.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Në lidhje ndjekjen e ecurisë së këtij rekomandimi, ka dalë Urdhri i Prokurimit me nr. 372, datë 25.09.2024, i Kryetarit të Bashkisë, me objekt "Implementim i softwer për financën dhe drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore".

Rekomandimi është në proces zbatimi

8.2. Rekomandimi: Sektori i Strehimit dhe Regjistrimit të Pronave të marrë masa për përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor dhe regjistrimin e tyre në ASHK.

Drejtoria e Burimeve Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Strehimit dhe Regjistrimit të Pronave, të llogarisë në buxhetin e PBA dhe buxhetin vjetor fondet e nevojshme për regjistrimin e pasurive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Kavajë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Në lidhje ndjekjen e ecurisë së këtij rekomandimi, ka dalë Urdhri i Prokurimit me nr. 372, datë 25.09.2024, i Kryetarit të Bashkisë, me objekt “Implementim i softwer për financën dhe drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore”.

Rekomandimi është në proces zbatimi

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Kavajë, të marrë masa që përpara miratimit të lejeve të ndërtimit të verifikohet se aplikimi i kryer është në përputhje me të gjitha kriteret dhe kondicionet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe në Planin e Detajuar Vendor, të tilla si: koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensiteti i ndërtimit, lartësia e ndërtimit, distancat dhe tipologjia e lejuar sipas njësisë strukturore përkatëse, sipas përcaktimit të tyre, në aktet përkatëse, në kohë dhe hapësirë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 42 prot., datë 07.01.2025, ka dal urdhri i punës nga Kryetari i Bashkisë për kartelizimin e subjekteve në Njësinë Administrative Kavajë;

Me shkresën nr. 48/1 prot., datë 08.01.2025, ka dal urdhri i punës nga Kryetari i Bashkisë për kartelizimin e subjekteve në Njësinë Administrative Luz i Vogël;

Rekomandimi është në proces zbatimi

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Kavajë të marrë masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa verifikuar paraprakisht dokumentacionin e pronësisë, i cili duhet të pasqyrojë gjendjen ligjore të kërkuar, si dhe miratimet/konfirmimet nga institucionet përkatëse për saktësinë dhe vërtetësinë e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi mbi ndjekjen e procedurave që janë marrë nga Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij rekomandimi mbeten për t’u parë në auditimin e radhës që do të zhvillohet nga KLSH me objekt “Auditim Përputhshmërie”.

Rekomandimi është në proces zbatimi

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Kavajë të marrë masa për miratimet e nevojshme nga institucionet përkatëse gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi dhe për leje ndërtimi, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi mbi ndjekjen e procedurave që janë marrë nga Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij rekomandimi mbeten për t’u parë në auditimin e radhës që do të zhvillohet nga KLSH me objekt “Auditim Përputhshmërie”.

Rekomandimi është në proces zbatimi

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kavajë, të marrin masa për ndjekjen e zbatimit të punimeve në referencë me lejen e ndërtimit. Në rast se destinacioni përfundimtar i objektit të ndërtimit, për të cilin do të lëshohet certifikata e përdorimit, është i ndryshëm nga ai i reflektuar në lejen e ndërtimit, të bëhet rillogaritja e diferencës së taksës së ndikimit në infrastrukturë TNI sipas VKB Kavajë me nr.107, datë 22.11.2022, duke aplikuar gjithashtu, ndaj subjektit përkatës, nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

Statusi i rekomandimit: I pranuar

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi mbi ndjekjen e procedurave që janë marrë nga Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij rekomandimi mbeten për t'u parë në auditimin e radhës që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Auditim Përputhshmërie".

Rekomandimi është në proces zbatimi

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit Kavajë, në lidhje me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin nr. 4934, datë 04.01.2023, të cilëssojë shoqërinë aplikuese "C. C." ShPK si subjekt të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", datë 03.05.2018, neni 19, pika 1, duke siguruar kalimin pa shpërblim, në favor të fondit publik të banesave sociale, të 3% të sipërfaqes funksionale të objektit, nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate për kalim pronësie dhe regjistrimin e kësaj të fundit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi mbi ndjekjen e procedurave që janë marrë nga Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij rekomandimi mbeten për t'u parë në auditimin e radhës që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Auditim Përputhshmërie".

Rekomandimi është në proces zbatimi

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Kavajë të marrë masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për miratimin e certifikatës së përdorimit dhe për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura, si edhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi mbi ndjekjen e procedurave që janë marrë nga Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij rekomandimi mbeten për t'u parë në auditimin e radhës që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Auditim Përputhshmërie".

Rekomandimi është në proces zbatimi

15.1. Rekomandimi: Kryeinspektori IMT-së Bashkia Kavajë, të nxjerrë Urdhër Ekzekutimi për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për **25** subjekte që janë me Vendim për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm".

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, është lëshuar kërkesa për lëshimin e urdhër ekzekutimit për subjektet si më poshtë:

Nr.	Subjekti	Likuiduar	Banka
1	S. C.	305	17.01.2023
2	M. M.	303	17.01.2024
3	M. M.	307	17.01.2024
4	S. V.	306	17.01.2024
5	B. T.	301	17.01.2024
6	Z. H.	322	17.01.2024
7	E. K.	316	17.01.2024
8	G. V.	298	17.01.2024
9	T.	296	17.01.2024
10	R. Sh.	297	17.01.2024
11	N. L.	299	17.01.2024
12	C. C.	300	17.01.2024
13	M. T.	302	17.01.2024
14	I. A.	312	17.01.2024
15	I. M.	311	17.01.2024
16	L. D.	308	17.01.2024
17	E. ShPK	310	17.01.2024
18	H. C.	309	17.01.2024
19	S. K.	318	17.01.2024
20	M. Xh.	314	17.01.2024
21	A. D.	304	17.01.2024

22	B. C.	323	17.01.2024
23	R. K.	321	17.01.2024
24	I. Gj.	320	17.01.2024
25	J. M.	319	17.01.2024
26	D. V.	317	17.01.2024
27	M. M.	315	17.01.2024
28	E. K.	313	17.01.2024

Rekomandimi është në proces zbatimi

- 16.1. Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Bashkia Kavajë, të marrë masa për:
- Mbajtjen e akt kontrolleve për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit.
 - Të mos lejuar asnjë ndërtim të zhvillohet në kushtet e mungesës së lejes së zhvillimit dhe të ndërtimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
 - Shkëmbimin e informacionit me DPKZHT dhe rritjen e bashkëpunimit midis tyre. Kryerjen kontrolle periodike mbi objektet në zhvillim, të pajisur me leje ndërtimi, për të verifikuar nëse zbatimi i punimeve kryhet sipas projektit të miratuar.
 - Hartimin e informacion periodik tre mujor ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe dhe vendimet e marra.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi mbi ndjekjen e procedurave që janë marrë nga Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij rekomandimi mbeten për t'u parë në auditimin e radhës që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Auditim Përputhshmërie".

Rekomandimi është në proces zbatimi

- 17.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces, si vijon:

A. Masa organizative

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë, Drejtoria Ekonomike, gjatë planifikimit të buxhetit, të marrë masa për planifikimin e trajnimeve të punonjësve, në mënyrë të tillë për mbarëvajtjen e punës në bashki, sa i përket pozicioneve të punës përkatëse për secilin punonjës.

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, drejtorët e drejtorive, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

1.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë Juridike të ngrejë grupin e punës për kryerjen e planit të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kavajë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditimin tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja, për të pasqyruar aktivitetin e drejtorive të ngarkuara për zbatimin, me qëllim për mbarëvajtjen e punës në bashki.

3.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë, për çdo vit buxhetor të marrë masa të ngrejë Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe me Grupet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe ne bashkëpunim me to, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që planifikimi i shpenzimeve buxhetore PBA dhe të vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, duke u bazuar në kërkesat e sektorëve dhe dëgjesa me publikun me palët e interesit.

- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

- Drejtoria e Burimeve Ekonomike të përgatisë raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit (4 mujore), jo vetëm vjetore, duke i paraqitur në KB dhe krahas tyre të paraqesë dhe një material për uljen e detyrimeve në mënyrë të kontrolluar.

4.1. Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara, për të cilat të bëhet përcaktimi i plotë i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet. Gjithashtu të përgatitet një plan për daljen nga situata e vështirë financiare dhe paraqitja në Këshillin Bashkiak një material për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale dhe sipas programeve, dhe të hartojë një grafik likuidimi, duke zbatuar radhën e pagesave, ku të shqyrtohen të gjitha mundësitë dhe rriten burimet e financimit, duke përdorur fondin rezervë dhe të kontingjencës, rishikimin e buxhetit, rritjen e nivelit të të ardhurave si dhe negociminin me kreditorët për të ristrukturuar pagesat për detyrimet e konstatuara dhe të pa likuiduara.

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerën 1,907,396 lekë në aktivin e Bilancit të fund vitit 2023 me artikujt kontabël në debi të llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit, në kredi të llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në pasiv të bilancit, për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

6.1. Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për evidentimin në mënyrë të plotë dhe të saktë të të drejtave për arkëtim të debitorëve. Këto veprime të kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë, duke përfshirë në gjendjen e llog. 468 “debitorë të ndryshëm” debitorët për detyrimet e lindura nga rekomandimet e shpërbllim dëmit të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë vlerën prej 122,396,352 lekë AA jo materiale duhet të realizojë inventarin kontabël sipas investimeve përkatëse dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi si pjesë e kostonë së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektime të duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në Bashkinë Kavajë të marrë masa që të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet të AAGJM, duke saktësuar gjendjet e llogarive të klasës 21 në aktiv të bilancit dhe duke ribërë klasifikimin e saktë të aktiveve në llogaritë përkatëse, sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik, të bëjë rakordimin e inventarëve të tyre si dhe përcaktimin e plotë të vlerës së plotë të çdo aktivi, që nga vlera fillestare me gjithë shtesat dhe pakësimet, shoqëruar me korrektime kontabël për amortizimet, si dhe duke i finalizuar me evidentimin e tyre aktiv për aktiv në librin historik të hartuar sipas formatit të përcaktuar ligjor.

9.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

10.1. Rekomandim: Titullari i AK Bashkia Kavajë, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

11.1. Rekomandim: Titullari i njësisë vendore apo personi i autorizuar prej tij të miratojë për çdo rast urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni të përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision duhen të bëjnë pjesë jo më pak se tre anëtarë, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

12.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Kavajë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me planin e përgjithshëm vendor, ku të jenë respektuar kushtet e përcaktuara në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm për distancat nga objektet, nga rrugët kryesore, nga kufitarët.

13.1. Rekomandim: Kryeinspektori i IMTV të marrë masa që në bashkëpunim me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësisë vendore, apo dhe çdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektime të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare si bregdet, pyje apo zona të mbrojtura.

14.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre, si më poshtë:

14.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kadastrës Urbane Bashkia Kavajë të marrë masat e nevojshme, që procedura e dhënies me qira të dyqaneve të bëhet nëpërmjet konkurrimit publik. Gjithashtu të bëjë ndryshimin e formatit të kontratave në përputhje me përcaktimet ligjore, si dhe lidhjen e tyre nga e para me 14 subjektet qiramarrës.

15.1. Rekomandim: Titullari i AK Bashkia Kavajë, të marrë masa që në të ardhmen, për marrjen në dorëzim të investimeve publike, të ngrëjë grupe pune me specialistë të fushës së ndërtimit, në mënyrë që kontrolli i cilësisë së punimeve të bëhet sa më korrekt dhe objektet publike të investuara të vihen në shërbim të komunitetit në kohë dhe me cilësinë e duhur.

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelle e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kontratës.

Menjëherë

B. Masa për shpërblim dëmi

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,579,457 lekë pa TVSh** nga BOE "B." & "E. S." SHPK & "P. V." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 612/4 prot., datë 12.04.2021, me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Razi Leka"", Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,933,868 lekë pa TVSh** nga BOE "B." & "E. S." SHPK & "P. V." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 479/5 prot., datë 24.03.2021, me objekt "Rikonstruksion i shkollës së mesme "Aleksandër Moisiu"", Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,179,291 lekë pa TVSh** nga BOE "D." & "Z." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 507/3 prot., datë 04.06.2021, me objekt "Rikualifikimi i qendrës Kulturore "Aleksandër Moisiu", Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,914,240 lekë pa TVSh** nga OE "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4075/2 prot., datë 11.11.2020, me objekt "Vazhdim i punimeve për rikonstruksionin e Shëtitores nr. 2 dhe pajisja e disa rrugëve me polica të shtrirë", Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C. Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përlllogaritjen e gabuar të fondit limit, e cila ka sjellë përdorim pa ekonomikitet të fondeve në vlerën 7,248,258 lekë pa TVSH.

Menjëherë

D. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)

1.1. Rekomandim: Nga strukturat drejtuese dhe Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit të merren masa që planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale, i studiuar dhe i argumentuar, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e të ardhurave si dhe të mundësive të arkëtimin të tyre.

- Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit, për arkëtimin nga tatimpaguesit të vlerës debitorë prej 705,827,865 lekë të marrë të gjitha masat, që përveç nxjerrjes së njoftimit të vlerësimit tatimor, paralajmërimin e masave shtrënguese si dhe njoftimet e bllokimit bankar në bankat e nivelit të dytë për një pjesë të debitorëve të ndjekë të gjitha rrugët ligjore si:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare për pjesën tjetër të debitorëve të krijuar.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-Të bashkërendojë punën me QKB dhe DRTT, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë të marrë masa për plotësimin, saktësimin dhe përditësimin e të dhënave të nevojshme të regjistrin të taksapaguesve vendorë të kategorisë "Familjar" për Bashkinë Kavajë dhe NJA si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar për një planifikim sa më real. Gjithashtu të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat familjare.

3.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit në Bashkinë Kavajë në bashkëpunim dhe me specialistët të Drejtorisë së Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike në NJA, të marrë masa për saktësimin e të dhënave për tokën bujqësore e dhënë në përdorim/pronë si dhe përditësimin e regjistrin të taksapaguesve fermerë për taksën bujqësore për Bashkinë Kavajë dhe NJA, si bazë për llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar për një planifikim sa më real dhe të argumentuar. Gjithashtu të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat e tokës ndaj familjeve fermerë debitorë.

4.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Kavajë të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë të taksës së ndikimit në infrastrukturë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtime të reja që legalizohen. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Kavajë të bashkëpunojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), që krahas legalizimeve në zonat e stimuluar të marrë informacion periodik për të gjitha legalizimet, që kryhen në territorin e Bashkisë Kavajë si dhe të sigurojë një marrëveshje për bllokimin e veprimeve në dhënie të certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Mbrojtjes të Konsumatorit dhe Mjedisit të shqyrtojë dokumentacionin e 8 subjekteve debitorë dhe të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur të tarifës së autorizimit prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Kavajë për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022, si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur arkëtimet e plota brenda afateve.

6.1. Rekomandim: Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Kavajë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 13,009,282 lekë dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të

kontratave dhe nëse në rastet ku është e pamundur arkëtimi i debitorëve të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke parë dhe si mundësi anulimin e kontratave. Ndërsa në rastet e kontraktimit të parcelave pyjore me afat mbi 10 vjet të shikohet mundësia e rishikimit dhe amendimit të tyre me palët për korrektimin e këtyre kontratave sipas dispozitave ligjore në fuqi.

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Kadastrës Urbane e Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore dhe Borxhit Bashkia Kavajë, të marrë masat e nevojshme duke bërë ndryshimin në paketën fiskale të kohëzgjatjes së qiradhënies së hapësirës së plazhit (minimalisht 4-5 muaj me çmimin 100 lekë/m²/muaj) me qëllim rritjen e të ardhurave që arkëtohen nga tarifa e qiradhënies për objektin e mësipërm, si dhe eliminimin e efekteve negative financiar në buxhetin .

Menjëherë

E. Masat disiplinore.

E.I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:

a- Masa “Vërejte”, shkronja (a) e nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”

1. zj. D. Q., me detyrë drejtore e DPZHDK
2. z. S. V. me detyrë specialist në DPZHDK
3. z. H. Z. me detyrë specialist në DPZHDK
4. zj. M. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhura nga Taksat dhe Tarifave Vendore
5. z. Sh. K., specialist për taksat familjare në NJA Golem,
6. z. Th. D. specialist për taksat në NJA Helmas,
7. z. A. Ç. specialist për taksat familjare në Luz i Vogël
8. zj. E. Ç. specialist për taksat në NJA Synej.

b- “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 shkronja (c), për 4 (katër) punonjës si më poshtë:

9. z. R. I. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit (DTTVAB).

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar

Koment i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, rekomandimet që janë lënë nga auditimi i mëparshëm i ushtruar nga KLSH, janë në të njëjtën fazë.

Rekomandimi është në proces zbatimi

18.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë, të hartojë një program pune për evidentimin e të gjithë taksapaguesve familjar, për të krijuar regjistrin e plotë të tyre. Të bëhet optimizmi i të dhënave të taksapaguesve familjarë, të krijohet një strukturë për monitorimin e veprimtarisë në regjistrin elektronik, statistikave operacionale, zbatimin e rregullave të integritetit për ruajtjen e të dhënave, për të parandaluar regjistrimin e dyfishtë të taksapaguesve, modifikimin e të dhënave pa dokumentacion mbështetës, moslejimin për ndryshime të pa autorizuara të të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

19.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për sistemimin e organizimit të IMTV -së konformë kuadrin rregullator ligjor në fuqi, në mënyrë që të plotësojnë strukturën e me punonjës sipas kriterëve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Kjo problematikë u konstatua edhe përgjatë vitit 2024 konkretisht nuk ka ndryshime në strukturën e IMTV-së.

Rekomandimi nuk është zbatuar

20.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa që të pajisë me **Oponencë Teknike** çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me

kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi mbi ndjekjen e procedurave që janë marrë nga Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij rekomandimi mbeten për t'u parë në auditimin e radhës që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Auditim Përputhshmërie".

Rekomandimi është në proces zbatimi

21.1. Rekomandimi: AK në hartimin e DT, të shmangë aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi mbi ndjekjen e procedurave që janë marrë nga Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij rekomandimi mbeten për t'u parë në auditimin e radhës që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Auditim Përputhshmërie".

Rekomandimi është në proces zbatimi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015, "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Kavajë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **43,468,061 lekë**, si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,050,334 lekë** nga OE "G." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 43/3 prot., datë 09.02.2023, me objekt: "Rikonstruksion i kopshtit Hap pas Hapi", Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 3848 prot., datë 23.07.2024, Bashkia Kavajë është drejtuar OE "G." ShPK me njoftim për ekzekutimi vullnetar dëmi sipas rekomandimeve të KLSH.

Rekomandimi është në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **7,039,858 lekë** nga BOE "G. K." & "Sh." & "M." & "F." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 881/3 prot., datë 12.04.2022, me objekt: "Ndërtim i zjarrfikës Kavajë (ndërtesë & rrethim)", Bashkia Kavajë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 3849 prot., datë 23.07.2024, Bashkia Kavajë është drejtuar BOE "G. K." & "Sh." & "M." & "F." ShPK me njoftim për ekzekutimi vullnetar dëmi sipas rekomandimeve të KLSH.

Rekomandimi është në proces zbatimi

3.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **12,719,126 lekë pa TVSH** nga OE "A. I. G. C." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën së shërbimit me nr. 3568/3 prot., datë 02.10.2020, me objekt: "Shërbimi i pastrimit Njësia Administrative Golem", Bashkia Kavajë, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

4.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **22,658,743 lekë pa TVSh** nga BOE "A. I. C." ShPK & "A. I. G. C." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën së shërbimit me nr. 3568/3 prot., datë 09.12.2022, me objekt: "Shërbimi i pastrimit të Qytetit Kavajë dhe Njësive Administrative Synej, Luz i Vogël e Helmas", Bashkia Kavajë, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **15,237,176 lekë**, vlerë cila përbën të ardhura të munguara në dëm të buxhetit të njësisë. Përkatësisht:

- Nga shoqëria "C. C." ShPK të arkëtohet vlera **12,920,465 lekë**;

- Nga shoqëria "D. K." ShPK të arkëtohet vlera **2,316,711 lekë**.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për kryerjen e pagesave të planifikuara dhe të papaguara për kredinë e marrë nga Banka Qendrore Evropiane (CEB), në shumën **7,670,516 lekë** të bëjë kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të llogarive në mënyrë që pasqyrat financiare të sigurojnë informacion të saktë për pozicionin financiar të kredisë. Drejtoria Burimeve Ekonomike në çdo rast të kryejë kontabilizime të sakta dhe të plota të veprimtarisë ekonomike të njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Nga auditimi u konstatua se për është kryer pagesa për vitet 2020-2024, në vlerën 24,991,551 lekë sipas Urdhër Shpenzimit nr. 1226, datë 06.08.2024. Ndërsa vlera prej 10,636,66 lekë e mbetur e huasë është e kontabilizuar në gjendjen e llogarisë 16,17,18 "Huatë Afat Gjata" si detyrim për t'u paguar në vijimësi.

Rekomandimi është zbatuar

3.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të identifikojë çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë, si dhe të planifikojë detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se, nga Bashkia Kavajë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin nga **20** subjektet në shumën **6,088,673** lekë, taksë ndërtesë (tendë) dhe tablele për qëllime reklamimi.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Lidhur me këtë situatë është likuiduar shuma totale 142,942 lekë nga Subjekti "O." ShPK vlera prej 32,176 lekë me transaksionin e datës 25.04.2024, në R... dhe "M." Shpk vlera prej 110,766 lekë me transaksionin e datës 03.05.2024, në R...

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Konsumatorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe liçensimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa liçensën për aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 270 prot., datë 16.01.2025, Bashkia Kavajë është drejtuar me njoftim për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa liçensë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, naftës etj., për përdorim nga konsumatorët fundorë, ISHTI, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Rekomandimi është në proces zbatimi

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Konsumatorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara për **20** subjekte me vlerë **13,116,667** lekë, si vijon:

- Për **10** subjekte që nuk janë pajisur me liçencë 5 vjeçare por me autorizim 1 vjeçar në vlerën **8,000,000** lekë;
- Për **3** subjekte që ushtrojnë aktivitetin pa liçencë pas përfundimit të vlefshmërisë në vlerën **2,100,000** lekë;
- Për **5** subjekte debitor fund të vitit 2022 për vlerën **2,800,000** lekë, sipas tabelave faqe 36-74 të RPA;

- Për **2** subjekte me vlerë **2,816,667** lekë, që zhvillojnë aktivitetet pa u identifikuar dhe regjistruar në regjistrin, konkretisht: Subjekti Xh. S., person fizik me NIPT K.... dhe Subjekti A.... ShPK me NIPT L.....

- Për **20** subjekte me vlerë **200,000 lekë** që ushtrojnë aktivitetet “24 orësh” me qëllim aplikimin dhe pajisja me leje aktiviteti 24 orësh, sipas tabelës faqe 36-74 të RPA.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 1728 prot., datë 17.04.2025; nr. 4610 prot., datë 16.09.2024; nr. 3562 prot., datë 02.07.2024; nr. 4611 prot., datë 16.09.2024; nr. 6409/1 prot., datë 27.12.2024; nr. 6409 prot., datë 27.12.2024; nr. 6211 prot., datë 16.12.2024; nr. 624 prot., datë 16.12.2024; nr. 366 prot., datë 22.01.2025; nr. 2332 prot., datë 23.04.2024, Bashkia Kavajë ka dërguar pranë subjekteve që tregtojnë hidrokarburet dhe derivatet e tyre me pakicë njoftim për shlyerjen e detyrimeve. Me shkresën nr. 2332/1 prot., datë 23.04.2024, Bashkia Kavajë ka dërguar pranë subjekteve që tregtojnë hidrokarburet dhe derivatet e tyre me pakicë që ushtrojnë aktivitetet “24 orë” njoftim për shlyerjen e detyrimeve.

Rekomandimi është në proces zbatimi

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **7,205,204** lekë për subjektet ndërtuese të pajisura me leje ndërtimi, që kanë ushtruar veprimtari ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Kavajë dhe nuk janë pajisur me certifikatë regjistrimi për adresë dytësore për çdo kantier ndërtimi për vitin 2023 sipas përcaktimeve në paketë fiskale të paraqitura në Anekset nr. 6 dhe nr. 7. (“2.2.6 Të Ardhurat” bashkëngjitur RPA.).

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Duke u bazuar në mandat pagesat e kryer nëpërmjet llogarive bankare u konstatua se, nga vlera prej 7,205,204 lekë është arkëtuar vlera prej 2,368,269 lekë për subjektet të cilat nuk kanë qenë të pajisura me Nipt Sekondar, sipas listës së mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Likuiduar	Banka	Datë
1	B.	112,131	U...	10.05.2024
2	B.	112,131	B...	05.08.2024
3	K. C.	33,913	B...	19.11.2024
4	K. C.	100,958	B...	19.11.2024
5	K. C.	100,958	B...	19.11.2024
6	K. C.	100,958	B...	19.11.2024
7	K. C.	100,958	B...	19.11.2024
8	K. C.	33,913	B...	19.11.2024
9	K. C.	100,958	B...	19.11.2024
10	K. C.	56,262	B...	19.11.2024
11	R. K.	134,480	U...	04.12.2024
12	P. V.	115,732	U...	31.01.2024
13	Sh. P.	112,131	B...	09.05.2024
14	V. T.	134,480	B...	23.05.2024
15	Xh.	123,307	O...	09.10.2024
16	Xh.	52,262	O...	09.10.2024
17	E.	78,608	C...	02.12.2024
18	E.	100,958	C...	02.12.2024
19	K. C.	100,958	B...	19.11.2024
20	E.	11,563	B...	27.12.2024
21	V. T.	11,563	B...	20.05.2024
22	E.	11,563	C...	02.12.2024
23	V. T.	22,739	L...	14.05.2024
24	I. C. & P.	22,739	C...	13.05.2024
25	E. T.	45,086	C...	02.12.2024
26	B. SH.P.K	67,435	B...	23.05.2024
27	Sh. M.	11,563	B...	13.05.2024
28	P. F. G. A.	33,913	B...	16.05.2024
29	K. C.	33,913	B...	19.11.2024
30	E. T.	134,480	C...	02.12.2024
31	R. & S. V.	13,397	C...	17.05.2024
32	L.	7,501	B...	19.11.2024
33	S. F. ShPK	20,204	C...	27.05.2024
34	B. C.	57,277	C...	29.07.2024
35	M. C.	57,277	B...	18.07.2024
Totali		2,368,269		

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **4,020,853** lekë detyrim për taksë

pasurie e paluajtshme (ndërtesë dhe truall), pas pajisjes me Certifikatë Përdorimi për vitin 2023 për **22** subjektet paraqitur në Aneksin nr.8 bashkëlidhur RPA.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Në vlerën prej 2,368,269 lekë të likuiduar në lidhje me rekomandimin nr. 7.1, është përfshirë edhe vlera e shlyer e debitorëve për taksën e pasurisë. Gjithashtu nga Bashkia Kavajë, DTTVAB me shkresën tip nr. 2565 prot., datë 08.05.2024, është drejtuar 22 subjekteve me njoftim rivlerësimi të detyrimit.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin e regjistrimit të taksapaguesve privat dhe familjar për taksën e tokës bujqësore, duke evidentuar qytetarët të cilët kanë marrë tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saj, në hektar për secilin Mbi bazën e këtij regjistri të llogariten dhe të arkëtohen detyrimet për taksën e tokës bujqësore në shumën prej **6,198,107 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Me Urdhrin nr. 74, datë 17.04.2024, të Kryetarit të Bashkisë, janë pezulluar shërbimet e kërkuar për debitorët e taksës së tokës bujqësore deri likuidimin e detyrimit.

Rekomandimi është në proces zbatimi

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të identifikojë çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e bashkisë, si dhe të planifikojë detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme sipas rastit (pronar/ ose bashkëpronar).

Të marrë masa që të plotësojë dosjet e subjekteve me të gjithë dokumentacionin mbështetës, për saktësimin e sipërfaqeve të cilat shfrytëzohen nga subjektet për qëllime aktiviteti ekonomik si dhe të ndiqen të gjitha procedurat përkatëse administrative dhe ligjore për vendosjen e statusit juridik të tyre, sipas përcaktimit në listën e inventarit të pronave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 2465 prot., datë 10.06.2025, të Kryetarit të Bashkisë ka dal urdhri i punës për rifreskimin e dosjesve të subjekteve dhe regjistrimin e subjekteve të reja.

Rekomandimi është në proces zbatimi

8.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **243,689 lekë** e cila u përket **5** subjekteve që kanë rezultuar me diferencë midis akt verifikimit dhe planifikimit.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se është likuiduar shuma totale prej 230,003 lekë për katër subjekt si më poshtë:

1. E.... vlerën 62,063 lekë në datë 27.05.2024, B.....;
2. E. C. ShPK vlerën 58,125 lekë në datë 10.05.2024, B...;
3. F. S. H. & R. Shpk vlerën 89,968 lekë, në datë 20.05.2024, B.....;
4. K. R. 19,847 lekë, në datë 10.05.2023, O...;

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **16,326,291 lekë**, nga dhënia me qira e kontratave për dyqaneve për 4 subjektet në shumën **99,360 lekë**, nga dhënia me qira e banesave sociale për 21 familjet për shumën prej **4,845,417 lekë**, Nga dhënia me qira e tokës bujqësore për 5 subjektet në shumën **8,707,016 lekë**, nga dhënia me qira e hapësirave stacione plazhi për 4 subjektet në shumën **1,964,100 lekë** dhe nga dhënia me qira e hapësirave publike për

3 subjekte në shumën totale prej 710,400, konkretisht për subjektin E. B. në shumën 230,400 lekë, D. C. në shumën 240,000 lekë dhe B. ShPK, në shumën 240,000 lekë.

Brenda datës 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve që lindin për taksa dhe tarifa vendore me qëllim shmangien e mundësisë për çregjistrimin e tyre pa shlyer detyrimet tatimore, për 1,807 subjekte në shumën totale **236,970,755 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

10.2. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa të koordinojë punën me institucionet e ndërlidhura me qëllim marrjen dhe dhënien e informacioneve në kohë reale për mos lejuar mbylljen e subjekteve pa bërë likuidimin e detyrimeve fiskale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

11.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe IMTV-ja të marrin masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave të vendosura nga IMTV për vlerën **20,300,000 lekë**. Gjithashtu, të merren masat për përlllogaritjen e kamatvonesës dhe vjeljen e saj në çdo rast që gjobat nuk paguhen brenda afateve të përcaktuara, për vendosjen në dijeni dhe rritjen e bashkëpunimit me Shërbimin Përmbarimor, si dhe Drejtorinë e Burimeve Ekonomike Bashkia Kavajë.

Brenda datës 30.12.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Me shkresën nr. 207 prot., datë 11.01.2024, z. M. R. është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm me Memo informuese në lidhje me situatën debitore deri më datë 31.12.2023.

Rekomandimi është në proces zbatimi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kavajë dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi mbi ndjekjen e procedurave që janë marrë nga Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij rekomandimi mbeten për t'u parë në auditimin e radhës që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Auditim Përputhshmërie".

Rekomandimi është në proces zbatimi

E. MASA DISIPLINORE

Bazuar në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Kavajë**, marrjen e masave si më poshtë:

a. Bazuar në nenin 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të vijojë me marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion me shkallën e shkeljes.

b. Bazuar në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë" dhe kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara, fillimin e dhënies së masave disiplinore për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i Grupit të Auditimit: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, nuk disponohet një urdhër nga titullari i institucionit për ndjekjen e këtij rekomandimi, për më tepër nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se Bashkia Kavajë, nuk ka ngritur një sistem efektiv për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim konkretisht:

- Bashkia Kavajë nuk ka rishikuar rregulloren e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë nuk ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mire përcaktuara;
- Nuk ka një miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe nuk ka hartuar plane vjetore të punës për të gjitha Drejtoritë;
- Nuk rezulton të ketë Urdhër për miratimin e Planit të Veprimit për Kontrollin e Brendshëm dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij Plani;
- Nuk ka asnjë procedurë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj;
- Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës;
- Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.
- Bashkia nuk zhvillon takimet e GMS, të dokumentuara me procesverbale përkatëse;
- Nuk ka hartuar strategjinë dhe regjistrin e risqeve, si rrjedhojë e kësaj nuk ka plan-veprime për menaxhimin e riskut. Konstatohet mungesa e monitorimit dhe raportimeve në mënyrë periodike për risqet me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre. Bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi;
- Nuk ka hartuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës, si edhe nuk janë hartuar hartat dhe manualet e proceseve të punës. Faqja zyrtare e institucionit nuk përditësohet rregullisht dhe punonjësit nuk kanë e-mail zyrtar;
- Nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II, neni 8, neni 16, pika 2, nent 20-24, VKM nr. 833, datë 28.10.2020, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrin qendror të personelit”, Kreu II “Dosja e Personelit”, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3, pika 3.2.1, pika 4, pika 5.2.7, Manualin për MFK-në i miratuar me Urdhrin nr. 108/2016, Kapitulli III, pika 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, Koordinatori i Riskut dhe Koordinatori i MFK - së të marrë masa për:

- Përditësimin e rregullores së brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore të institucionit.
- Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performance, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
- Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin e konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.

- Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike. Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Kavajë përgjatë vitit 2024, u konstatua se:

Nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Kavajë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë. Auditimi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara. Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve dhe nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të MAB. Nuk është kryer auditim tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja; NjAB nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike varësie ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Këto veprime janë në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa për shqyrtimin e risqeve më të rëndësishme për planifikimin dhe zbatimin e projekteve, programeve në të cilat janë fokusuar objektivat strategjike të njësisë publike. Gjithashtu Raportet dhe dosjet e auditimit të hartohen dhe plotësohen me të gjithë elementët dhe dokumentacionin respektiv, duke përmbytur njëkohësisht edhe detyrimet ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Kavajë së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2024, kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2024 totali i buxhetit është planifikuar në vlerën 3,260,717 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 2,240,806 mijë lekë në masën 69% ose me një mosrealizim në vlerën 1,019,911 mijë lekë. Mosrealizimi i të ardhurave, do të thotë se nga Bashkia Kavajë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 39, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9, pika 1.3, gërma “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, VKB përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Kavajë, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kavajë në datën 01.01.2024, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 793,941,976 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 737,626,479 lekë me një pakësim në vlerën 56,315,497 lekë. Nga auditimi u konstatua se, në planin buxhetor të vitit 2024 nuk ka planifikuar grafik për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura konkretisht nuk është likuduar asnjë vlerë nga detyrimet e prapambetura. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 55, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162 dhe nenin 52 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike Financës të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është në vlerën 744,448,000 lekë dhe realizimi në vlerën 1,036,818,312 lekë ose në masën 139.2% me një diferencë tejkalimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 292,370,312 lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore rezulton se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin (tejkalim që ka ndodhur nga arkëtimet e taksës ndikimit në infrastrukturë e cila është planifikuar në vlerën 310,000 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 584,261 mijë lekë në masën 188.4%), gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nën-pika “c”, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të kryej parashikime të bazuara në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por, edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifatat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare të Bashkisë Kavajë për vitin ushtrimor 2024 janë depozituar pranë Degës së Thesarit (DTH) Kavajë me shkresën nr. 1507 prot., datë 05.06.2025, dhe konfirmuar nga DTH me shkresën nr. 122 prot., datë 05.06.2025, jashtë afatit ligjor. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli V, pika 118. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike të merren masa që hartimi dhe depozitimi i pasqyrave financiare vjetore, pranë degës së thesarit, të kryhet brenda afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore përkatëse.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të Klasës 4, konkretisht llogarive të arkëtueshme konstatohet se:

- Gjendja e llogarisë 411 “*Klientë e llogari të ngjashme*” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,872,258 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 6,613,237 lekë me një rritje në vlerën 3,740,979 lekë. Në gjendjen e llogarisë 411 “*Klientë e llogari të ngjashme*” janë përfshirë detyrimet që kanë Çerdhet dhe Kopshtet e qytetit ndaj institucionit në vlerën 2,872,258 lekë. Për diferencën në vlerën prej 3,740,979 lekë e pasqyruar në bilanc është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie. Llogaria 411 “*Klientë dhe llogari të ngjashme*” është llogari që debitohet në kredi të llogarive 71 analizat përkatëse për të ardhurat nga shitja. Kjo vlerë i përket gjendjes debitoare të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, në kredi të llogarisë 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” në pasiv të bilancit.

- Gjendja e llogarisë 423,429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 91,540,628 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 91,540,628 lekë pra kjo llogari nuk ka shtesa apo pakësime. Llogaria 423,429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)*”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 91,540,628 lekë është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie.

- Gjendja e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 747,814,846 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 879,878,586 lekë, të cilat konsiderohen detyrime të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Kavajë, me një rritje në vlerën 132,063,740 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” nuk janë të përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Me shkresën nr. 1214 prot., datë 17.03.2025, Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, të Ardhurave dhe Borxhit mbi borxhin tatimor progresiv më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 879,878,586 lekë pa përfshirë debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “*Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë*” me kundërparti llogarinë 468 “*Kreditorë të ndryshëm*”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pika 3.2, pika 4.2, pika 5, pika 7, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për analizimin, detajimin e dokumentacionit ligjor për diferencën në vlerën 3,740,979 lekë që i përket çeljes së llogarisë 411 “*Klientë e llogari të ngjashme*” me qëllim saktësimin e vlerave në pasqyrat financiare.

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë detajimin e dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogarinë 423 dhe 429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)*” të kontabilizuara në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet.

7.3. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave, të Ardhurave dhe Borxhit të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468

“Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”.

Deri më datë 31.03.2026

8. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 125,701,505 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 7,555,680 lekë, pakësime në vlerën 14,185,880 lekë amortizim të akumuluar në vlerën 18,855,226 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 100,216,079. Vlera e mbetur në fund të vitit 2024 prej 122,396,352 lekë (*që i përket kostos historike*) e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për projekt-studime të pa analizuara për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.

Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik. Për këto vlera duhet të detajohen sipas investimeve dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II, Aneksi 1, pika 2, klasa 2, dhe pika 5. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke riklasifikuar në llogaritë e investimeve përkatëse sipas llojit në vlerën 122,396,352 lekë për një paraqitje të plotë e të saktë të aktiveve afatgjata materiale, si dhe aplikimin e normës së amortizimit.

Deri më datë 31.03.2026

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në gjendjen e llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” është kryer si veprim sistemues, pakësim në vlerën 878,207 lekë, që i përket aplikimit të normës së amortizimit për këtë llogari për vitin 2023. Ndërkohë që sistemimi i vlerës prej 878,207 lekë referuar trajtimin kontabël duhej t’i shtohet vlerës së aktivitetit dhe jo të kryej pakësimi i vlerës së amortizimit. Sipas informacionit kontabël llogaria 210 “Toka, troje, terrene” është nënvlerësuar në vlerën 878,207 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 36. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2025 të bëjë sistemimin e vlerës 878,207 lekë e cila ka të bëjë me veprimin sistemues të gabuar lidhur me përlllogaritjen e normës së amortizimit, duke i shtuar vlerës së aktivitetit në gjendjen e llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”.

Deri më datë 31.03.2026

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të Klasës 20, konkretisht aktiveve afatgjata materiale u konstatua se:

a. Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” e pasqyruar në bilanc për vlerën 35,121,363 lekë dhe llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” në vlerën 10,971,000 lekë, janë të pa analizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari.

b. Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 1,312,690,760 lekë kosto historike është përfshirë vlera 263,494,134 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë e paanalizuar ndikon

në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Pjesë e analizës së kësaj llogarie janë kontabilizuar 5 aktive jo me vlerë plotë.

c. Në gjendjen e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 3,437,945,420 lekë kosto historike është përfshirë vlera 569,988,759 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

d. Në gjendjen e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” në vlerën 154,454,921 lekë kosto historike është përfshirë vlera 29,552,098 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Kavajë e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë analizë të detajuar të dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogaritë e aktiveve afatgjata të Klasës 20, (210, 212, 213 dhe 215) për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 31.03.2026

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)*” për llogarinë 218 “*Inventar ekonomik*” është përlllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2024, në vlerën 86,574,832 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 “*Pajisje kompjuterike*” nga aktivet e llogarisë bazë 218 “*Inventar ekonomik*” e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike në gjendjen e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” të klasifikojë veçmas llogarinë 218/6 “*Pajisjet kompjuterike*” në regjistrin e aseteve të njësisve dhe pasqyrat financiare, konform kërkesave të nomenklaturës së llogarive, duke aplikuar amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv.

Deri më datë 31.03.2026

12. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 “*Për aktivet afatgjata materiale*” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,842,855,911 lekë. Për këtë llogari nuk disponohet informacion mbi shtesat dhe pakësimet e kësaj llogarie, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,597,687,327 lekë. Nga auditimi u konstatua se, nuk dokumentohet pakësimi i 77 objekteve në gjendjen e llogarisë 231 “*Për aktive afatgjata materiale*” në vlerën 1,287,219,125 lekë pra shpërndarja e tyre në aktiv. Ndërkohë që shtesa për vitin 2024 në gjendjen e llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” është 68,181,062 lekë dhe 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” është 3,198,000 lekë. Për më tepër nuk disponohet analiza për vlerën 1,555,636,786 lekë të

mbetur të çeljes së datës 01.01.2024. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi nr. 1, Klasa 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor të llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” për nxjerrjen e të dhënave për vlerën 1,555,636,786 lekë që i përket investimeve të kryer ndër vite dhe të diferencës ndërmjet çeljes dhe shtesave, pakësime në vlerën 1,287,219,125 lekë, për të verifikuar saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare.

Deri më datë 31.03.2026

13. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 2,597,687,327 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 2,597,687,327 lekë. Ky total nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, gërma “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të evidentojë pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

Deri më datë 31.03.2026

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik”, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

2. Nga auditimi u konstatua se Bashkisë Kavajë janë transferuar në total 3,176 pasuri si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat 2,645 pasuri në pronësi dhe 531 pasuri në përdorim sipas VKM-ve përkatëse, nga të cilat janë pajisur me çertifikatë pronësie 201 pasuri. Përgjatë vitit 2024 nuk është kryer asnjë aplikim për pajisjen me çertifikatë pronësie. Për aktivitetet që i përkasin llogarive 210, 211, 212 dhe 213, Bashkia Kavajë të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 201 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie, ndërsa për pjesën tjetër të aseteve të paraqitura në kontabilitet, regjistrimi i tyre si aktiv është kryer në mungesë të dokumentacionit të pronësisë.

Nga Bashkia Kavajë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210, 211, 212 dhe 213. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë asetëve të llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 211 “*Pyje, kullota plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i asetëve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e asetëve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Vlera e detyrimeve më datë 31.12.2024, për llogarinë 436 “*Sigurime shoqërore*” sipas urdhër shpenzimeve dhe akt-rakordimit me Degën e Thesarit Kavajë është në vlerën 1,748,837 lekë ndërsa në pasqyrat financiare është contabilizuar vlera 1,731,737 lekë me një diferencë në vlerën 17,100 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, pika 3.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë contabilizimin e saktë të llogarisë 436 “*Sigurime Shoqërore*” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Deri më datë 31.03.2026

16. Gjetje nga auditimi: Llogaria 464 “*Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë*” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 1,242,000 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 16,550 lekë me një pakësim në vlerën 1,225,450 lekë, e pasqyruar në bilanc është e paanalizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të analizojë vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare të llogarisë 464 “*Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë*” të kontabilizuara në vite.

Deri më datë 31.03.2026

17. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Kavajë në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 148,335,565 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%.

- Nga gjendja e llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” disponohet analiza përkatëse vetëm për vlerën 94,948,632 lekë ndërsa për diferencën në vlerën 53,386,933 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të kësaj llogarie.

- Për 22 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Kavajë janë ngurtësuar fonde në vlerën 23,525,242 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Kavajë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike nuk janë marrë masa për zhblllokimin e këtyre fondeve si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 23,525,242 lekë. Këto veprime janë kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes,*

paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 3.3 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kryejë zbatimin e dokumentacionit financiar e ligjor për vlerën 53,386,933 lekë të pa analizuar në kontabilitet që i përket llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Deri më datë 31.03.2026

17.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kavajë, në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrë masa për kalimin e fondeve të secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimit të kryer për periudhën e garancisë.

Brenda datë 31.12.2025

18. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 8,049,666,667 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 135,180,102 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 14,637,945 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 31,183,231 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 254,399,416 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 494,125,791 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 17. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Ekonomike të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

Deri më datë 31.03.2026

19. Gjetje nga auditimi: Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Kavajë administruar në KLSH me nr. 1088/9 prot., datë 07.03.2025, dhe protokolluar në Bashkinë Kavajë me nr. 1143 prot., datë 11.03.2025, ku janë lënë për zbatim **32** masa organizative, **1** masë për shpërblim dëmi në vlerën 1,505,840 lekë dhe **1** masë disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 32 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 11 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 20 masa nuk janë zbatuar.

b. Për shpërblim dëmi është rekomanduar 1 masë në vlerën 1,505,840 lekë e cila është pranuar plotësisht dhe është e pa zbatuar.

c. Masa disiplinore është rekomanduar 1 masë e cila është pranuar plotësisht dhe është e pa zbatuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe atyre në proces zbatimi si më poshtë:

a. Për 1 masë organizative të zbatuar pjesërisht dhe 20 masa të pa zbatuara: nr. 1.1, 5.1, 5.2, 5.3, 6.1, 8.1, 9.1, 11.1, 11.2, 12.1, 13.1, 17.1, 18.1, 18.2, 21.1, 22.1, 22.2, 23.1, 23.2, 24.1;

b. Për 1 masë për shpërblim dëmi, të pa zbatuar: nr. 1.1;

c. Për 1 masë disiplinore të pa zbatuar: nr. 1.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Kavajë administruar në KLSH me nr. 34/17 prot., datë 05.06.2024, ku janë lënë për zbatim **22** masa organizative, **4** masa për shpërblim dëmi në vlerën 43,468,061 lekë, **15** masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, me efekt mungesë të ardhurash, **1** masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike dhe **1** masë disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 22 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar plotësisht, 3 masa janë zbatuar pjesërisht, 14 masa janë në proces zbatimi dhe 4 masa nuk janë zbatuar.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 4 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 2 masa janë në proces zbatimi dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

c. Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, me efekt mungesë të ardhurash janë rekomanduar 15 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar plotësisht, 4 masa janë zbatuar pjesërisht, 5 masa janë në proces zbatimi dhe 5 masa nuk janë zbatuar.

d. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike është rekomanduar 1 masë e cila është pranuar plotësisht dhe është në proces zbatimi.

e. Masa disiplinore është rekomanduar 1 masë e cila është pranuar plotësisht dhe nuk është zbatuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kavajë të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe atyre në proces zbatimi si më poshtë:

a. Për 3 masa organizative të zbatuar pjesërisht, 14 masa në proces zbatimi dhe 4 masa të pa zbatuara: nr. 1.1, 2.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 8.1, 8.2, 9.1, 10.1, 11.1, 12.1, 13.1, 14.1, 15.1, 16.1, 17.1, 18.1, 19.1, 20.1 dhe 21.1;

b. Për 2 masa për shpërblim në proces zbatimi dhe 2 masa të pa zbatuara: nr. 1.1, 2.1, 3.1 dhe 4.1;

c. Për 4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike të zbatuar pjesërisht, 5 masa në proces zbatimi dhe 5 masa të pa zbatuara: nr. 1.1, 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 5.1, 6.1, 7.1, 8.1, 8.2, 9.1, 10.1, 10.2 dhe 11.1;

d. Për 1 masë eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike në proces zbatimi: nr. 1.1;

e. Për 1 masë disiplinore e pa zbatuar: nr. 1.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE

B.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

B.1.1 PËR PUNONJËSIT TË CILËT JANË PJESË E SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të shkronjës “c”, neni 15, “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në zbatim të nenit 58, “*Llojet e masave disiplinore*” të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar me Ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen*”

në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kavajë, që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për 1 punonjës të mëposhtëm:

1. Për z. A. C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Ekonomike në cilësinë e nëpunësit zbatues, hartues i pasqyrave financiare, për shkeljet:

- Për depozitim të pasqyrave financiare jashtë afatit ligjor në Degën e Thesarit;
- Për kontabilizimin e vlerës 3,740,979 lekë që i përket llogarisë 411 “*Klientë e llogari të ngjajshme*” e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie;
- Për kontabilizimin e vlerës 91,540,628 lekë që i përket llogarisë 423,429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)*” e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të kësaj llogarie;
- Për mos kontabilizimin e debitorëve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”;
- Për kontabilizimin e vlerës prej 122,396,352 lekë që i përket llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, për projekt-studime të pa analizuar për investime të kryera, të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme;
- Për kryerjen e veprimeve sistemuese në gjendjen e llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, pakësim në vlerën 878,207 lekë që i përket aplikimit të normës së amortizimit për këtë llogari për vitin 2023. Ndërkohë që sistemimi i vlerës prej 878,207 lekë referuar trajtimit kontabël duhej t’i shtohet vlerës së aktivitetit dhe jo të kryej pakësimi i vlerës së amortizimit.
- Për kontabilizimin e vlerës 35,121,363 lekë që i përket llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*” dhe vlerës 10,971,000 lekë llogarisë 211 “*Pyje, kullota, plantacione*” të pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari;
- Për përfshirjen në gjendjen e llogarive 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” vlerën 263,494,134 lekë; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” vlerën 569,988,759 lekë dhe 215 “*Mjete transporti*” vlerën 29,552,098 lekë të pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike;
- Për llogarinë 218 “*Inventar ekonomik*” është përllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2024, në vlerën 86,574,832 lekë (*kosto historike*) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 “*Pajisje kompjuterike*” nga aktivet e llogarisë bazë 218 “*Inventar ekonomik*” e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%;
- Gjendja e llogarisë 231 “*Për aktivet afatgjata materiale*” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 2,842,855,911 lekë. Për këtë llogari nuk disponohet informacion mbi shtesat dhe pakësimet e kësaj llogarie, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,597,687,327 lekë. Nga auditimi u konstatua se, nuk dokumentohet pakësimi i 77 objekteve në gjendjen e llogarisë 231 “*Për aktive afatgjata materiale*” në vlerën 1,287,219,125 lekë pra shpërndarja e tyre në aktiv. Ndërkohë që shtesa për vitin 2024 në gjendjen e llogarisë 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” është 68,181,062 lekë dhe 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” është 3,198,000 lekë. Për më tepër nuk disponohet analiza për vlerën 1,555,636,786 lekë të mbetur të çeljes së datës 01.01.2024;
- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “*Investime për aktive afatgjata jo materiale*” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” në vlerën 2,597,687,327 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 2,597,687,327 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “*Nga fondet e veta të investimeve*” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “*Teprica e grandeve kapitale të brendshme*” në vlerën 0 lekë;
- Për kontabilizimin si veprim sistemues të vlerës 1,225,450 lekë nga gjendja e llogarisë 464 “*Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë*”;

- Për mos disponimin e analizave përkatëse të vlerës 53,386,933 lekë që i përket gjendjes së llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”;
- Për nënvlerësimin në vlerën 494,125,791 lekë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar”;

C. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Kavajë, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

Për punonjësit e tjerë të cilët kanë rezultuar me mangësi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre institucionale, nuk rekomandojmë masa disiplinore, për shkak të nivelit të ulët të materialitetit sasior dhe cilësor.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT